



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Menaxhim Hoteleri - Turizëm”

Kolegji Universitar “Qiriazi”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Klodiana GORICA

Prof. Asoc. Ermelinda KORDHA

Korrik/ 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Menaxhim Hoteleri - Turizëm"**

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "Qiriazi"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Menaxhim Biznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Menaxhim Hoteleri - Turizëm"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 262, datë 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti 2023-2024: 20 PAE / 2 PAK
18	Numri i studentëve:	2023-2024 5 Studentë; 2022- 2023 8 Studentë; 2021- 2022 10 Studentë;
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Ky program është hapur me UMASR nr. 262, datë 19.07.2021. Sipas këtij urdhëri, veprimtaria akademike për këtë program studimi fillon në vitin akademik 21-22. Kolegji Universitar Qiriazi ka një përvojë 16 vjeçare në fushën e ekonomisë, dhe siguron disponueshmëri dhe kapaciteteve akademike cilësore si edhe kushte fizike optimale, për t'ju përgjigjur si stafit akademik me kohë të plotë ashtu edhe atij me kohë të pjesëshme, por vecanerisht për të siguruar cilësinë e mesimdhënies në një infrastrukturë të mireorganizuar.

Ky program studimi ofrohet nga njesia baze që është departamenti Menaxhim Biznesi pranë Fakultetit të Ekonomisë, Kolegji Universitar Qiriazi. Plani Strategjik i Zhvillimit të Kolegjit Universitar Qiriazi përcakton qartë objektivat e zhvillimit institucional prej nga rrjedh dhe strategjia e programit të studimit. Fakulteti i Ekonomisë, (KUQ) dhe Departamenti "Menaxhim Biznesi", janë përgjegjësit kryesorë për përmbushjen e misionit, objektiveve dhe të realizimit me nivel e cilësi të programit të studimit Bsc në "Menaxhim Hoteleri Turizëm". Ky program studimi, ka kohëzgjatje 3 (tre), vite akademike. Çdo vit akademik është (60) kredite (ECTS). Me plotësimin e së paku të (180), krediteve (ECTS), në përfundim të të cilave lëshohet diploma Bachelor, "Menaxhim në Hoteleri-turizëm".

Misioni i programit të studimit "Menaxhim Hoteleri Turizëm", është në përputhje me misionin e "KUQ", i cili synon të përgatisë specialistë me formim të shëndoshë profesional, shkencor dhe social, të cilët do të jenë të aftë që t'ju paraprijnë zhvillimeve të shpejta ndërkombëtare dhe gjithashtu do të jenë në gjëndje, t'i përshtasin këto zhvillime në ekonominë e vendit tonë.

Programi i studimit "Menaxhim Hoteleri Turizëm", ofron dije të qëndrueshme dhe të krahasueshme me ato të sistemit arsimor Europian, përmes të cilave transmetohen njohuri në disiplinat shkencore e profesionale për përgatitjen e specialistëve të rinj, të aftë që ti shërbejnë zhvillimit ekonomik dhe social në nivel kombëtar, rajonal dhe më gjerë. Detyrë themelore e programit të ciklit të parë të studimit "Menaxhim Hoteleri Turizëm", është që të bashkërendojnë procesin e mesimdhënies dhe mesimnxënies, kërkimit shkencor dhe aftësimin profesional e praktik, me qëllim sigurimin e cilësisë së tij.

Objektivi i programit të studimit "Menaxhim Hoteleri Turizëm", reflektohet edhe nga vizitat në institucion, takimet me stafet drejtuese dhe ato manaxheriale, por reflektohet edhe në dokumentat strategjike është sigurimi i cilësisë, dhe ky objektivi realizohet nëpërmjet garantimit të standardeve, si edhe duke bërë propozime për të aktivizuar të gjitha potencialet dhe mekanizmat përkatëse, një rol të rëndësishëm të hartimit dhe zbatimit të strategjive përkatëse në përmirësim të vazhdueshëm.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Hoteleri Turizëm" ka ndjekur hapat rigoroze të cilat janë në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Procesi nisi me kontaktin me ekspertët, si edhe mbi përdorimin e sistemit elektronik, në seksionin paneli i ekspertit. Në këtë fazë të parë u vendos një komunikim i mirë i grupit të punës, i përbërë nga ekspertët dhe Koordinatori Teknik i ASCAL Znj. Rajna Lila.

Pas njohjes dhe vlerësimit të dosjes së vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, u hartua axhenda e vizitës në institucion. Në fazën e dytë, u zbatua me rigozitet axhenda e takimeve në 19.02.2024, gjatë vizitës në institucion.

GVJ mblodhi informacion të nevojshme për një vlerësim rigoroz bazuar në takime me Përgjegjësin e Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financave, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulës, Sekretarinë mësimore, Burimet Njerëzore dhe Studentët e programit të studimit. Të gjitha informacionet e mbledhura nga takimet, u përdorën nga grupi i vlerësimit të jashtëm, i përbërë nga Prof. Dr. Klodiana Gorica dhe Prof. As. Ermelinda Kordha për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm.

Gjatë të gjithë procesit GVJ u asistua dhe nga koordinatori teknik i ASCAL.

Më datë 18.06.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 76/15 Prot., Datë 18.06.204, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlersimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 106 Prot, Datë 24.06.2024.

Komentet e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, për Programin e Studimit Bachelor në "Menaxhim Hoteleri-Turizëm".

GVJ duke vlerësuar komentet e Institucionit, përcjell qëndrimin rreth tyre si më poshtë:

Standardi II.1/kriteri 2:

Në Draft RVJ shprehet se Është sugjeruar edhe përgjatë vizitës në institucion se është e nevojshme prania e një lënde turizmi në kategorinë e lëndëve formuese baze A. Pra, është e nevojshme të bëhet një rigrupim i tyre me qëllim që të identifikohet edhe rëndësia e këtyre lëndëve të turizmit edhe në këto klasifikime.

Pa cënuar rëndësinë e lëndëve të tjera ekonomike ose jo, në këtë program studimi, duhet të prioritetizohen lëndët e turizmit, dhe vetë turizmi dhe hoteleria duhet të zënë më shumë peshë si në kredite dhe orë, ashtu edhe në praninë e tyre përmes shportave të lëndëve me zgjedhje.

Qëndrimi i GVJ:

Në zbatim të Ligjit 80/2015, për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, dhe në vijim të procesit të vlerësimit të jashtëm për programin e studimit *Bachelor në "Menaxhim Hoteleri-Turizem"*, GVJ I përbërë prej Prof. Dr. Klodiana Gorica dhe Prof. Asoc. Dr. Ermelinda Kordha ju drejtohet me këtë memo, në përgjigje të komenteve të dërguara nga institucioni me dokumentin e datës 02.07 2024.

Duke mbajtur parasysh procesin e vlerësimit të jashtëm, në vijim të tij dhe pas leximit të argumentimit, ju bëjmë me dije se:

- Në lidhje me standartin II.1 kriteri 2, raporti është shprehur qartë mbi sygjerimet specifike për lëndët.
- Komenti I institucionit pranon konstatimin e problematikave dhe angazhohet për t'i zbatuar në një të ardhme të afërt.


Në këto kushte gjykojmë që raporti qendron i pandryshuar.

Ju faleminderit!

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof. Dr. Klodiana Gorica

Prof. Asoc. Dr. Ermelinda Kordha



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Menaxhim në Hoteleri turizëm”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</p> <p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programë studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Në të gjitha dokumentat strategjike që ka ndërtuar dhe zbaton institucioni, rezulton se programi i studimit jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtare por synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare, i shërben direkt sektorit specifik dhe në mënyrë direkte të gjithë ekonomisë shqiptare duke ndikuar fort edhe në rritjen dhe cilësinë mbarëkombëtare të mësimdhënies, kulturës dhe vlerave akademike kombëtare. Nenet përkatëse brenda statutit kanë identifikuar misionin dhe objektivat të cilat më tej shtjellohen edhe në dokumentat e tjerë të rëndësishëm.</p> <p><i>Evidenca 3_3: Plani Sstrategjik i zhvillimit te programit te studimit bachelor “Menaxhim Hoteleri Turizem” (2022-2027)</i></p> <p><i>Evidenca 1_2 Strategjia e Zhvillimit Strategjik Institucional I Kolegjit Universitar Qiriazi. 2021 2026</i></p> <p><i>Evidence 1_1: Statuti KUQ</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Mbështetur në dokumentat më të rëndësishëm strategjike të institucionit të lartë, të njësisë bazë dhe asaj kryesore vihet re një përputhje cilësore në arritjen e objektivave, në metodologjinë, në qasjen e qartë si dhe në mbështetjen që institucioni ka dhe kryen në përputhje me qëllimet dhe misionin e tij sikurse edhe në fushën e veprimtarive. Misioni i programit të studimit “Menaxhim Hoteleri -Turizëm”, është në përputhje me misionin e “KUQ”, i cili synon të përgatisë specialistë me formim të shëndoshë profesional, shkencor dhe social, të cilët do të jenë të aftë që t’ju paraprijnë zhvillimeve të shpejta ndërkombëtare dhe gjithashtu do të jenë në gjëndje, t’i përshtasin këto zhvillime në ekonominë e vendit tonë.</p> <p><i>Ev. 1.1. Statuti KUQ</i></p>



	<p><i>Evidenca 3_3: Plani Strategjik i zhvillimit te programit te studimit bachelor "Menaxhim Hoteleri Turizem" (2022-2027)</i></p> <p><i>Evidenca 1_2 Strategjia e Zhvillimit Strategjik Institucional I Kolegjit Universitar Qiriaz. 2021 2026</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.</p>	<p>Programi që ofrohet nga ky departament, dhe që është në përputhje me qëllimet dhe misionin e KUQ të përmendura më sipër dhe të përcaktuara në dokumentet themelore të tij si Statuti, Rregullore e Studimeve Universitare, Planin e Zhvillimit Strategjik etj, si dhe me fushat e veprimit të tij, synon pajisjen e studentëve me njohuritë bazë mbi këtë sektor të ekonomisë. Eksiston një përputhje nga analiza e dokumentave strategjike në nivel institucional me ato të zbërthyer më tej në detaje në nivele fakulteti dhe departamenti, si njësi bazë që është përgjegjëse për këtë program studimi.</p> <p><i>Evidenca 3_6: Rregullore e e programit te studimit bachelor Manaxhim Turizem dhe Hoteleri. 2021</i></p> <p><i>Aneks 1_3 Plani strategjik i zhvillimit te institucionit</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>E identifikuar si një pikë e fortë për programin, edhe nga dokumentat por edhe diskutimet me drejtuesin e departamentit dhe Dekanin e këtij Fakultetit, ka rezultuar se Kolegji Universitar Qiriaz ka një koherencë të gjatë në treg, dhe përbën një ndër IAL e hapura herët në tregun e arsimit të lartë me një eksperiencë shumëvjeçare të mëparshme. Stafit i lëndëve kryesore ekonomike është cilësor dhe i njohur në vend, pasja e një programi 2 vjeçar profesional në turizëm bën që të ketë një eksperiencë paraprake në këtë sektor, sikurse njësi bazë që e ofron është cilësorë për të gjithë IAL, rrjedhimisht një bazë e mirë për të mbështetur dhe këtë program studimi. Për të ndjekur këtë linjë duhet që edhe stafi që jep mësim në lëndët e turizmit të diversifikohet (në numër) dhe të rritet cilësia e tyre. Pra, përderisa në lëndët e tjera ekonomike apo ato bazë janë profesorë me emër në fushë, është e nevojshme që kjo të shoqërohet me rritje sasiore dhe cilësore të stafit si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm që jep mësim në lëndët e turizmit. Bëhet fjalë për një program mësimor në turizëm, prandaj është bazike cilësia e mësimdhënies dhe stafet që japin mësim në këto lëndë.</p> <p><i>Ev.1_4_Rregullore e KUQ, Aneksi 1,</i></p> <p><i>Ev.2_6_Stafi Akademik sipas departamenteve të FE.</i></p>

	<i>Ev. 3_11_ Stafit akademik që jep mësim në programin e studimit në MHT.</i> <i>Ev.1_24_Infrastruktura mësimore e KUQ.</i>			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor, në “Menaxhim Hoteleri - Turizëm”, është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të përgjithshme, të Fakultetit të Ekonomisë dhe i shërben misionit të tij. Ky program i përket ciklit të parë (Bachelor) dhe kategorisë së (6) të kornizës evropiane dhe asaj shqiptare të kualifikimit. Shtrihet në tre vite akademike, me një total prej 6-të semestrash dhe përmban (180) ECTS, leksionet zhvillohen të gjitha në gjuhën shqipe dhe i korrespondon kodit në vijim: 63BA0413S. <i>Ev.2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë, neni 16,17,</i> <i>Ev.3_4_Rregullore e Departamentit</i> <i>Ev.2_17_Nivelet e kornizës së kualifikimeve të programeve të studimit.</i>			
Konkluzione	<i>Shkalla e përmbushjes së standardit është e plotë duke qenë se përmbushen të gjitha kriteret e këtij standarti, përfshirë përshtatjen dhe përputhjen me prioritetet kombëtare, strategjinë dhe planet afatgjata të institucionit, përputhjen me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e	Kolegji Universitar “Qiriazi”, ka realizuar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me Institucione të Arsimit të Lartë, brenda e jashtë vendit, si shtetërore e shoqëri private, për të zhvilluar veprimtari e aktivitete të ndryshme kërkimore, shkencore, promovuese dhe kualifikuese si dhe për realizimin e praktikave dhe mundësinë e punësimit të studentëve për gjithë programet e studimit në tërësi dhe në veçanti edhe për programin e studimit “Menaxhim Hoteleri- Turizëm”.




<p>personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Aktmarrveshjet e përbashkëta të KUQ, me institucione shtetërore si rasti i AQSH, kanë qënë shumë efikase dhe kanë ndikuar në zhvillimin e veprimatrive të ndryshme, në dobi të programit të ciklit të Parë Studimit Bachelor në Menaxhim Hoteleri Turizëm.</p> <p><i>Ev. 1_4_Rregullore e KUQ.</i> <i>Ev. 1_1_Statuti i KUQ.</i> <i>Ev. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.</i> <i>Ev. 3_2_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit.</i> <i>EV. 3_6_Rregullore e programit të studimit të MHT..</i> <i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC.</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Kolegji Universitar “Qiriazi” dhe Fakulteti i Ekonomisë kanë lidhur aktmarrëveshje me sipërrmarje private, agjensi e biznese të ndryshme, por edhe me institucione publike, të cilat janë në dobi të programit të studimit Bachelor në “Menaxhim Hoteleri-Turizëm”. Këto aktmarrëveshje janë nënshkruar në kuditër të praktikës profesionale të studentëve, mundësive së punësimit dhe zhvillimit të veprimtarive të interesit reciprok. Në këto lidhje krijohen baza të shëndosha për bashkëpunime në fushën e menaxhimit të bizneseve, projekte në lidhje me procesin akademik-mësimor, organizimin e konferencave të përbashkëta, orëve të hapura, tryezave të rrumbullaketa, vënie në dispozicion të ambjenteve/ mjeteve mësimore e laboratorike për zhvillim orësh mësimore, akses në bibliotekë dhe punë kërkimore.</p> <p><i>Ev3_4_Rregullore e programit të studimit të MHT.</i> <i>EV.3_28_Lista e marrëveshjeve në funksion të programit MHT.</i> <i>Ev.1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe aktorët e biznesit brenda dhe jashtë vëndit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave</p>	<p>E identifikuar nga përballja me dokumentacionin por edhe nga reflektimet e studentëve dhe stafit akademik, identifikohet se prania e orëve të praktikës që realizojnë studentët në këte program studimi është relativisht e dukshme, prezente dhe e reflektuar edhe në dokumentat shoqeruese. Studentët pothuajse për të gjitha modulet e mësimit, që në javët e para të mësimit kanë të përfshirë orë praktike në terren, duke i dhënë një sens mjaft praktik të gjithë këtij program studimi.</p>

profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	<p><i>Ev. 3_5 Plani strategjik i Programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_11 Stafit akademik që jep mësim në programet e studimit të MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_15 Rregullore e praktikës profesionale.</i></p> <p><i>Ev. 3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MHT.</i></p>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>Në analizën e punës të departamentit DMB, gjatë vitit akademik 2022-2023, janë trajtuar edhe problemet e bashkëpunimit me IAL, institucione shtetërore e firma private dhe përfitimi prej tyre, dhe departamenti e ka parë të domosdoshme që të bëhet një analizë e veçantë, vetëm për këtë problem, duke e konsideruar mjaft të rëndësishëm në rritjen e cilësisë së programeve të studimit.</p> <p><i>Ev. 1_4 Rregullore e KUQ.</i></p> <p><i>Ev. 1_1 Statuti i KUQ.</i></p> <p><i>Ev. 2_3 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p> <p><i>Ev. 3_2 Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit.</i></p> <p><i>EV. 3_6 Rregullore e programit të studimit të MHT..</i></p> <p><i>Ev. 1_5 Rregullore e NJSBC.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Institucioni arsimit të lartë KUQ në përmbushje të ofrimit të këtij programi studimi ka bërë përpjekje eficiente për të vendosur marrëdhënie bashkëpunimi. Departamenti ka prodhuar një raport të veçantë ku ka treguar dhe analizuar eficientësinë e marrëveshjeve të realizuara në mbështetje të këtij program studimi, të orientuara në disa drejtime. Nga ana tjetër, KUQ përmban koherencë të gjatë në treg, eksperiencë shumë vjecare, dhe një emër të mirë si pika të forta për të ofruar këtë program studimi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i Studimit në Ciklin e Parë Bachelor në “Menaxhim Hoteleri – Turizëm”, në Fakultetin e Ekonomisë, është mbështetur në modelin e programeve të Kartës së Bolonjës (<i>neni 3 Rregullorja prog të studimit</i>). Programi i studimit “Menaxhim Hoteleri Turizëm”, ofron dije të qëndrueshme dhe të krahasueshme me ato të sistemit arsimor European, përmes të cilave transmetohen njohuri në disiplinat shkencore e profesionale për përgatitjen e specialistëve të rinj, të aftë që ti shërbejnë zhvillimit ekonomik dhe social në nivel kombëtar, rajonal dhe më gjerë. Programi i Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në “Menaxhim Hoteleri-Turizëm”, i cili i përket kornizës së 6-shtë të kualifikimit, realizohet me ndjekje të mësimi me kohë të plotë, kohëzgjatja është tre vite akademike, dhe ndahet në gjashtë semestra, për secilin vitë grumbullohen përkatësisht nga (60) kredite, në përfundim të të cilëve studenti fiton 180 kredite (ECTS).</p> <p><i>Ev. 3_6_Rregullore e programit të studimit të MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_9_1 Plani mësimor i zgjeruar i programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_9_2 Kredite sipas veprimtarive formuse të programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 1_4_Rregullore e KUQ.</i></p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti i KUQ.</i></p> <p><i>Ev. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike</p>	<p>Sipas rregullores së këtij program studimi: Ky program ka për qëllim t’u mësojë studentëve kombinimin e dijeve teorike me aftësi konkrete, si dhe aftësinë për të zbatuar në praktikë koncepte teorike, në mënyrë që të jenë të aftë të përshtaten, të orientohen, dhe të kenë sukses në dinamikat komplekse të tregut të lirë, si dhe të përgatisë studentë të aftë për të vazhduar pa asnjë lloj kufizimi studimet në Ciklin e Dytë, në “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, të strukturuar sipas parimeve dhe Standardeve Europiane të Arsimit të Lartë.</p>

<p>të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p><i>Është sugjeruar edhe përgjatë vizitës në institucion se është e nevojshme prania e një lënde turizmi në kategorine e lëndëve formuese baze A. Pra, është e nevojshme të bëhet një rigrupim i tyre me qëllim që të identifikohet edhe rëndësia e këtyre lëndëve të turizmit edhe në këto klasifikime.</i></p> <p><i>Pa cënuar rëndësinë e lëndëve të tjera ekonomike ose jo, në këtë program studimi, duhet të prioritizohen lëndët e turizmit, dhe vetë turizmi dhe hoteleria duhet të zënë më shumë peshë si në kredite dhe orë, ashtu edhe në praninë e tyre përmes shportave të lëndëve me zgjedhje.</i></p> <p><i>Evidenca 3_3: Plani Sstrategjik i zhvillimit të programit të studimit bachelor “Menaxhim Hoteleri Turizem” (2022-2027)</i></p> <p><i>Ev. 3_9_1 Plani mësimor i zgjeruar i programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_9_2 Kredite sipas veprimtarive formuese të programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 1_4 Rregullore e KUQ.</i></p> <p><i>Ev. 1_1 Statuti i KUQ.</i></p> <p><i>Ev. 2_3 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Duke u bazuar edhe në takimet në institucion është sugjeruar dhe dakortësuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Duhet të përfshihen lëndë bazike të turizmit që formojnë njohuritë bazë dhe i shërbejnë direkt këtij programi studimi, psh “marketing i turizmit” apo “manaxhimi i turizmit të qëndrueshëm”, dhe “e-turizmi” apo “turizmi digital”; - Lëndë si “baza marketing” dhe “drejtim marketing” mund të shkrihen në një të vetme dhe në vend të dy lëndëve marketing të ofrohet vetëm baza marketing, dhe drejtimi marketingut të zëvendësohet me marketingun e turizmi; - Nuk mund të përfshihen shumë lëndë të historise dhe kulturës apo natyrës kur nuk ka lëndë të karakterit formues, ose edhe kur janë, çënohen për shkak të literaturës që nuk është e njëjta me emërtimin e lëndës; - Është sugjeruar që në një të ardhme të rishikohet shpërndarja e krediteve midis lëndëve. Kështu psh. Janë mjaft lëndë me 8 kredite, ndërsa lëndët e turizmit në përgjithësi janë me 5 kredite; - Lëndë si komunikimi apo drejtim SME të orientohe fort me tema drejt turizmit dhe hotelerisë. Të bëhen reflektimet në syllabuset me tema të vecanta që lidhen me SME në turizëm

	<p>apo çështje të komunikimit në turizëm. Kjo vlen edhe për lëndë të tjera që vete institucioni i gjykon të rëndësishme;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sugjerohen përfshirja e lëndëve me zgjedhje për vitin e 2 dhe të 3 akademik; - Vihet re një prani e madhe e lëndëve të përbërjes ushqimore në këtë program studimi, apo një theksim i çështjeve të laboratorëve në hoteleri; - Prezenca e një laboratory dhe e një programi professional në hoteleri krijojnë mundësi dhe komoditet për këtë program studimi, por duhet të theksohet se ky është një program bachelor, dhe duhet të bëhet dallimi i dukshëm me atë profesional 2 vjecar. Kështu, lëndë si ushqimi apo të ngjashme me këtë nuk kanë pse të jenë pjesë e këtij programi studimi dhe nuk ndikojne në formimin e aftësive për studentet, kjo i përket nivelit 2 vjecar të shkollimit professional; - Është e dukshme prania e lëndëve të kulturës dhe historisë jo vetëm në kompozimin e lëndëve të shpërndara në këtë program studimi por edhe në përbërjen e syllabuseve; - Sugjerohet fort që lëndët bazë të jenë të dallueshme si në praninë e tyre që në vitet e 1 dhe të 2, si me orë ashtu dhe me kredite, dhe syllabuse të formuara qartë dhe mirë që të sigurohet transmetimi i dijeve bazë; <p>Nga ana tjetër <u>sugjerohet</u> fort të ketë lëndë me zgjedhje për t'i dhënë mundësi jo vetëm studentit por për të reflektuar dhe tendencat kryesore sot në treg dhe për të tentuar për të qënë në të njëjtën linje me kurrikulat ndërkombëtare, aq më tepër që KUQ e synon këtë dhe e ka filluar me Austrinë. Lëndët me zgjedhje të jenë vetëm të turizmit, dhe të ketë lëndë me zgjedhje dhe në vitin e dytë edhe në vitin e tretë. Prania e lëndëve ekonomike është relativisht e madhe, numri i krediteve që marrin këto lëndë është i lartë. Në vitin e parë studentët bën vetëm 1 lëndë: baza turizmi, në semestrin e 2 të vitit të parë asnjë lëndë turizmi. Pra në vitin e parë, studenti bën vetem 1 lëndë. Sugjerohet që lënda: Manaxhim Turizmi të qëndrueshëm të bëhet sem. 2 të vitit të parë. Lënda Manaxhim turizmi mund të transformohet në manaxhim turizmi të qëndrueshëm, kjo për dy arsye:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konceptet kryesore të manaxhimit të turizmit si kërkesa oferta etj fare mirë përfshihen në baza turizmi, pra në thelb të dy lëndët kanë qasje të përafërt, prandja mjafton të mbetet lënda Baza Turizmi në sem e parë të vitit të parë, dhe në sem e dytë të vitit të parë të përfshihet
--	--

	<p>Manaxhim Turizmi Qëndrueshëm (në vënd të Manaxhim Turizmi që bëhet në vit të 3);</p> <ul style="list-style-type: none"> - Konceptet e turizmit të qëndrueshëm po dominojnë industrinë e turizmit në mbarë botën. Vendi ynë ka filluar të flasë vetëm me gjuhën e turizmit të qëndrueshëm, dhe kjo përbën edhe një ndër synimet kryesore të ekonomisë shqiptare, së cilës ne i shërbejmë me programet përkatëse. Teksa studenti përpqet të mësojë se si manaxhohet turizmi është më mirë t'a bëjë se si manaxhohen burimet për të synuar turizmin e qëndrueshëm, pra studenti përthith më shumë njohuri bashkëkohore, i reflekton ato në praktike, dhe programi reflekton përditësim koherent të kurrikulave.
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në lidhje me praktikën profesionale ajo është e përfshirë në kategorin D, me një nr kreditesh 8. Ndërkohe vihet re se pothuajse të gjitha lendet kane nje qasje shume praktike, studenti qe ne javet e para te lendeve shkon ne terren ne institucionet perkatese, kjo e ben kete program studimi interesant dhe me qasje praktike, e cila eshte e rendesishme. <u>Sugjerohet</u> qe lendet e vitit te 2, sem 4, dhe te vitit te trete sem 5 qe kane prapashtesen zhvillim i aftesive praktike ne Hoteleri tu hiqet, per disa arsye:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Eshte e mjaftueshme sasia e oreve te praktikes qe ben ne cdo lende dhe ne praktiken finale; - Eshte e ndjeshme dhe evidente sensi praktik I ketij programi studimi; <p>Nuk ka nevojte qe eshte te pakten 4 lende te tjera te kete kete prapashtese. Te mos harrojme se kemi te bejme me nje progtram studimi bachelor</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzimin të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Forma e organizimit të studimeve është me kohë të plotë dhe pranimi i studenteve behet sipas ligjit te arsimit te larte. Pranimet e studentëve në KU “Qiriazi” bëhen në përputhje me standardet e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore sipas parashikimeve ligjore te ë verifikuar dhe certifikuar nga MAS, përpara deklarimit të kuotave të pranimit nga KU “Qiriazi”. KU “Qiriazi”.</p> <p><i>Ev. 1_28_Kriteret e pranimit të studentëve në KU “Qiriazi”, për vitin akademik 2023-2024.</i></p> <p><i>Ev. 1_25_Vendimi i Bordit Administrativ për tarifa dhe bursa.</i></p> <p><i>Ev. 1_23_Kontrata me të tretët.</i></p>




	<i>Ref. https://qiriaz.edu.al/kriteret-e-pranimit-2/</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	<p>Programit të studimit i është bërë kodifikimi i cili është në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë sipas përcaktimeve dhe kërkesave.</p> <p>Programe të tilla ekzistojnë në treg, por me pak në forme specifike të menaxhimit të hotelerisë, por kryesisht në forme të përgjithshme të menaxhimit të turizmit. Gjithsesi lëndet baze si matematikë e zbatuar, menaxhim turizmi, menaxhim marketingu, Informatikë, mikroekonomi, makroekonomi, Gjuhë e huaj, Bazat e kontabilitetit, hyrje në finance, statistikë e aplikuar, Drejtim financiar, drejtim marketingu, janë në kuadër të aftësive themelore të menaxhimit dhe marketingut si në vitin e parë edhe përgjatë një pjese të vitit të dytë. Gjithashtu përgjatë vitit të dytë dhe të tretë, ka dhe lende të profilit të hotelierit turizmit që gjenden edhe në programe të tjera të kësaj natyre, Si psh menaxhimi i trashëgimisë kulturore, gjë që e bën programin në masën 70% të ngjashëm me programet e përmendura.</p> <p><i>Ref: Udhëzim Nr.31, datë 15.11.2022 "Për procedurat për Kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimin të Lartë në Republikën e Shqipërisë"</i></p>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	<p>Programi mësimor i lëndëve 3_9_1 Bachelor në "Menaxhim Hotelier Tur-izëm", përmban kodin e lëndës i cili është përcaktuar në disa variante nga ana e "KUQ", 3_34 dhe është në fazë përzgjedhëse nga "MAS".</p> <p><i>Ev. 3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_27. Propozimi i Komisionit mbi variantet e kodeve të programeve në KUQ.</i></p>
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N / A
Konkluzione	<i>Me qëllim që ky program studimi të përmbushë objektivat që ka synuar në dokumentat strategjike, që nga statutet e KUQ tek rregulloret e këtij program studimi, është e nevojshme të</i>

	<i>reflektohen disa sugjerime që lidhen si me syllabuset apo praninë e lëndëve të turizmit në këtë program. Kjo me qëllimin e sigurimit të pasjes së njohurive të duhura teorike, këto sugjerime janë diskutuar dhe dakortësuar me të gjitha nivelet përgjatë vizitës në institucion.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Departamenti i “Menaxhim Biznesit”, e ndjek në vazhdimësi zhvillimin normal të procesit mësimor dhe njëherazi zbatimin rigoroz të programeve të studimit dhe planeve mësimore të këtij programi. Departamenti plotëson detyrimin ligjor të (MAS), për të patur numrin prej 5 pedagogësh të rregullt nga të cilët 3 me tituj dhe grada shkencore, plus një pedagog me kohë të pjesëshme me titull akademik, kjo sipas evidences 3_10.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë është i organizuar nga tre njësi bazë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Financës; 2. Departamenti i Menaxhim Biznesit; 3. Qendër Kërkimore Shkencore FE; <p>Në analizat vjetore dhe takimet e mbledhjet me anëtarët e stafit akademik që japin mësim në këtë program studimi, të brendshëm e të jashtëm, në vazhdimësi objekt diskutimi bëhen eksperiencat në metodat e mësimdhënies me synim përfitimin e ndërsjellë dhe ofrimin në auditor të metodave më frytdhënëse. E mbështetur në dokumentacionin e venë në dispozicion rezultojnë se departamenti ka në fokusin e vet gërshetimin e mësimdhënies me mësimnxënien duke vendosur jo pedagogun por “studentin në qendër”. Struktura, përbërja, funksionimi, si edhe drejtimi i “FE-së përcaktohen qartë në statutin dhe aktet e tjera të KUQ1_2, si dhe në rregulloret e tij dhe të DMB. FE, drejtohet nga Dekani i cili zotëron titullin akademik Prof. Dr., në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë (80/2015). Të dhënat e departamentit përgjegjës për programin e studimit në vitin akademik 2023-2024 janë:</p>




Cilësia e stafit të Departamentit të Menaxhim Biznesit		
Titulli/Grada	2023-2024	
	PAE	PAK
Prof.Dr	1	-
Prof.Asoc.	1	-
Dr	1	-
Msc	2	-
Gjithsej	5	0

Evidenca 3_3: Plani Strategjik i zhvillimit te programit te studimit bachelor "Menaxhim Hoteleri Turizem" (2022-2027)

Evidenca 1_2 Strategjia e Zhvillimit Strategjik Institucional I Kolegjit Universitar Qiriaz. 2021 2026

Ev. 1_2_Akte nënligjore për KUQ.

Ev. 1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar „Qiriaz” (KUQ).

Ev. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.

Ev.3_5.Analiza vjetore e departamentit.

Ev. 3_10_Stafi akademik i Departamentit të Menaxhim Biznesit.

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Departamenti i “Menaxhim Biznesi”, e ndjek në vazhdimësi zhvillimin normal të procesit mësimor dhe njëherazi zbatimin rigoroz të programeve të studimit dhe planeve mësimore të këtij programi. Në analizat vjetore dhe takimet e mbledhjet me anëtarët e stafit akademik që japin mësim në këtë program studimi, të brendshëm e të jashtëm, në vazhdimësi objekt diskutimi bëhen eksperiencat në metodat e mësimdhënies me synim përfitimin e ndërsjellë dhe ofrimin në auditor të metodave më frytdhënëse. Është e dukshme edhe nga vizitat ne institucion se ka nje qasje mbeshtetese nga te gjitha instancat per kete program studimi. Qe nga stafi mesimdhenes, tek drejtuesi departamentit e tek dekani apo rektori dhe presidenti i institucionit e reflektuan kete qasje. Në takimet e zhvilluara në institucion me stafin u theksua se: vecoria e këtij programi është zhvillimi i aftësive (në komunikim shërbim) dhe tek marrëveshjet e bashkëpunimit (burgerland, modul i austrise dhe italia), apo investimet e bëra nga institucioni janë konsideruar</p>
---	--

	<p>si element pozitiv dhe mbështetës, apo synimi është që vetë universiteti të ketë një hotel shkolle që të mbulojë vetë të gjitha.</p> <p><i>Evidenca 3_3: Plani Sstrategjik i zhvillimit te programit te studimit bachelor “Menaxhim Hoteleri Turizem” (2022-2027)</i></p> <p><i>Ev. 1_2_Akte nënligjore për KUQ.</i></p> <p><i>Ev. 1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar „Qiriazhi ” (KUQ).</i></p> <p><i>Ev. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p> <p><i>Ev.3_5.Analiza vjetore e departamentit.</i></p> <p><i>Ev. 3_10_Stafi akademik i Departamentit të Menaxhim Biznesit.</i></p>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	<p>Ekziston një vendim për emërimin e kordinatorit nga që ka si detyrë të kujdeset për realizimin e misionit dhe veprimtarive të gjithanshme të këtij program studimi, sipas përcaktimit të detyrave të tij/saj në rregulloren e programit të studimit dhe në aneksin bashkëlidhur vendimit të emërimit. Ky vendim eshte bere me propozim të përgjegjës të njësisë bazë dhe stafit akademik si edhe me miratim të Dek-anit të Fakultetit.</p> <p><i>Ev. 3_6Rregullore e programit të studimit MHT</i></p> <p><i>EV. 3_8_Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit dhe detyrat e tij.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i></p> <p><i>“DMB”, është përgjegjës për këtë program studimi, dhe përmbushë të gjitha detyrimet ndaj Ligjit të Arsimit të Lartë (80/2015), dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij. “KUQ”, ka kaluar me rezultat pozitiv procesin e akreditimit institucional.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>E cituar ne dokumentat strategjike, detyrë themelore e programit të ciklit të parë të studimit "Menaxhim Hoteleri Turizëm", është që të bashkërendojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, kërkimit shkencor dhe aftësimin profesional e praktik, me qëllim sigurimin e cilësisë të tij. Pra objektivi i programit të studimit "Menaxhim Hoteleri Turizëm", është sigurimi i cilësisë, dhe ky objektivi realizohet nëpërmjet garantimit të standardeve, si edhe duke bërë propozime për të aktivizuar të gjitha potencialet dhe mekanizmat përkatëse, një rol të rëndësishëm të hartimit dhe zbatimit të strategjive perkatëse. "DMB", është përgjegjës për këtë program studimi, dhe përmbushë të gjitha detyrimet ndaj Ligjit të Arsimit të Lartë (80/2015), dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij. FE si njësi kryesore, së bashku me "DMB", si njësi bazë përgjegjëse për programin, disponojnë dokumentat e nevojshme për mirëfunksionimin dhe organizimin e tij. Ndrkohe qe këto njësi përgjegjëse për programin e studimit i publikojne informacionet rregullisht ne faqen e internetit.</p> <p><i>Ev. 1_2_Akte nënligjore për KUQ.</i></p> <p><i>Ev. 1_3_Rregullore e Kolegjit Universitar „Qiriazi” (KUQ).</i></p> <p><i>Ev. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p> <p><i>Ev.3_5.Analiza vjetore e departamentit.</i></p> <p><i>Ev. 3_10_Stafi akademik i Departamentit të Menaxhim Biznesit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Plani mesimor është një dokument shumë i rëndësishëm i cili reflekton qasjen konkrete të përpjekjes për të realizuar objektivat e vendosur në të gjitha dokumentat strategjike. Plani mësimor dhe programi mësimor i programit të studimit Bachelor në "Menaxhim Hoteleri- Turizëm" ka të reflektuar një detajim të ngarkesës mësimore, orët në auditor të ndara sipas leksioneve, seminareve, praktikave, orë të pavarura jashtë auditorit, komponenti mësimor dhe kreditet për secilin prej tyre.</p> <p>Detajimi i ngarkesës mesimore është i tillë që janë shpërndarë 60 kredite në secilin vit akademik, sipas legjislacionit në fuqi. Për çdo vit janë shpërndarë duke ju dhënë peshën e duhur leksioneve dhe seminareve. Psh përgjate vitit të parë orët total të këtyre krediteve janë 660 orë dhe të ndara perkatësisht në 360 orë leksione dhe 300 orë seminare.</p>

	<p><i>Ev. 3_9_1_Plani mësimor i zgjeruar i programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>EV. 3_9 Programi mësimor i MHT..</i></p> <p><i>Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MHT</i></p> <p><i>Ev. 3_6_Rregullore e programit të studimit të MHT.</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Te dhenat dhe kriteret e transferimeve, te pranimit apo ekuivalentimit jepen ne menyre te rregullt. Kanalizimi i këtij informacioni kryhet në rrugë të ndryshme institucionale, mediatike dhe internetit.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Ne nenin 22 te rregullores se ketij programi studimi citohet qarte aspekti i transferimeve. Aty thuhet se Fakulteti i Ekonomisë, në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të Fakultetit nëpër shkolla të tjera; 2. Studentëve të regjistruar në këtë program studimi mund t'u njihen kredite të fituara në programe të tjera studimi, në fusha të njëjta ose të përafërta studimi. Procesi i vlerësimit të Kurrikulës dhe njohjes së lëndëve bëhet nga Komisioni i Ekuivalentimit. Transferimi i studentëve është i lirë. Në rast njohjeje, studenti mbart notën me të cilën është vlerësuar në programin e mëparshëm të studimit ose pjesën e frekuentimit të saj; 3. Transferimet do të pranohen vetëm në fillim të çdo viti akademik, sa e parashikon Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; <p><i>Ev. 1_36_Faqja zyrtare e internetit (www.qiriaz.edu.al.) të KUQ.</i></p> <p><i>Ev. 3_6_Rregullore e programit të studimit të MHT.</i></p> <p><i>Ev. 1_28_Kriteret e pranimit e transferimit të studentëve.</i></p> <p><i>Ev. 3_2_Dosja e programit të studimit Bachelor MHT.</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo</p>	<p>Në lidhje me syllabuset duhet theksuar se nga analiza përmes dokumentave të vena në dispozicion u konkluduan disa momente te cilat jane reflektuar me lart. Keto u diskutuan ne detaje qe ne takimin e pare me Dekanin dhe Drejtuesin e Departamentit, me stafet dhe grupin e RVB, dhe ne takimin permbylles. Ky program studimi shoqerohet nga syllabuset te cilet reflektojnë te gjithë informacionin, ngarkesën, literaturë,</p>




<p>orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>qasjen teorike dhe atë praktike, ndarjet e oreve, duke bërë e mundur dhe kthyer syllabusin në një dokument kritik i cili reflekton se dijet janë transferuar, se dijet janë të qarta dhe të plota, etj. Te gjitha këto momente janë dhënë me detaje pak më lart.</p> <p><i>Rekomandimet me rishikimin e syllabuseve përbëjnë ndër rekomandimet kryesore, duke filluar që me reflektimin e VKM nr 41 në to, të përditesimit të literaturës, të përfshirjes së literaturës shqiptare, të sigurimit të koncepteve kryesore teorike që janë transmetuar, të mos përplasjes së temave midis lëndëve përkatëse, etj.</i></p> <p><i>Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MHT.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>E diskutuar përgjate vizites në institucion, por edhe e identifikuar nga përfaqësuesit me dokumentacionin rezultojnë se syllabuset e këtij programi studimi kanë nevojë të reflektojnë literaturat në gjuhën shqipe dhe ato të viteve të fundit, kanë nevojë të analizohen dhe diskutohen midis departamentit për të shmangur përplasjet e temave, etj. Programi që po akreditohet po nxjerr vitin e parë të studenteve të tij, megjithatë <u>sugjerohet</u> një reflektim çilesor në përmbajtjen e çdo syllabusi për të cilin janë dhënë sugjerime (kryesisht ato të turizmit apo një përpjekje për të dhënë koncepte të turizmit në lëndët ekonomike). Ky reflektim është i rëndësishëm edhe për studentet aktual të viteve të dyta dhe të para.</p> <p><i>Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_7_Studimi i tregut të punës për programin e studimit.</i></p> <p><i>Ev. 3_4_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga pikepamja e forms ky program studimi përmban planin mesimor të plotë me të dhënat e detajuara të oreve krediteve, etj përmes së cilit student merr të gjithë informacionin paraprak. Përmirësime në drejtim të përmbajtjes janë të detajuara në këtë raport vlerësimi, të konsultuara dhe dakortësuara me të gjitha njesitë përgjate vizites në institucion.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	




Standardi II.4


Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga pikepamja formale plani mesimor i programit të studimit përmbush kërkesat e legjislatcionit në fuqi. Por si në emërtimin e lendeve, pra përzgjedhjen e tyre, si në përmbajtjen e tyre në disa komponente, sic janë literaturat apo disa tematika, plani mesimor që përmbledh të gjithë shpërndarjen e lendeve dhe të praktikave (bazuar edhe në detajimet e lendeve edhe përmes syllabuseve të tyre) kanë rezultuar se lendet dhe shpërndarja e tyre lënë disa hapësira për të mundësuar thellimin në nivelin e duhur të njohurive apo të aftësive baze të studenteve.</p> <p><i>Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MHT.</i> <i>Ev. 3_7_ Studimi i tregut të punës për programin e studimit.</i> <i>Ev. 3_4_ Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesi.</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Për këtë program studimi është ofruar një dokument që lidhet me studimin e tregut të punës, studim i cili është i përgjithshëm mbi situatë të caktuara apo fotografime të disa momenteve të tregut. Filluar që me nevojën për të përputhur me shumë titullin dhe objektivin që ka ky program studimi (hoteleri dhe turizmi) me emërtimet, llojet e lendeve, nr e krediteve, të reflektuara në to.</p> <p><i><u>Ka nevojë për përmirësime sasiore (të përfshirjes të më shumë lëndëve bazë dhe shportave të lëndëve me zgjedhje) dhe cilesore që i referohen përmbajtjes së syllabuseve përkatëse.</u></i></p> <p><i>Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MHT.</i> <i>Ev. 3_7_ Studimi i tregut të punës për programin e studimit.</i> <i>Ev. 3_4_ Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesi.</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe</p>	<p>Ky program studimi është për turizmin dhe hotelierinë dhe duhet të reflektojë qartë dhe dukshëm vëmendjen që nga stafi që jep mësim, ndarjen e lëndëve midis stafit, analizës së përpjekjes për të reflektuar përmirësimet e syllabuseve në këto</p>




<p>e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>3 vite, të përfshirjes së literaturave të dekadës së fundit dhe të gjuhës shqipe, etj.</p> <p>Me reflektimin e këtyre sugjerimeve të përfshira edhe në fund të këtij raporti në formën e rekomandimeve do të sigurohet se objektivat që ka vendosur ky program në dokumentat strategjike janë reflektuar edhe përmes lëndëve përkatëse që përmban plani mësimor.</p> <p><i>Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MHT.</i> <i>Ev. 3_7_ Studimi i tregut të punës për programin e studimit.</i> <i>Ev. 3_4_ Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesi.</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Lëndët/modulet ndahen sipas kategorive të veprimtarive formuese:</p> <p>A - Lënda bazë (15%-20%); B – Lënda karakterizuese (50%-55%); C – Lëndë ndërdisiplinore/integruese (12%-15%); D – Lëndë plotësuese (10%-15%); E – Detyrimet përmbyllëse (3%-5%);</p> <p>Ky kategorizim i lëndëve/moduleve në kurrikul është plotësisht në përputhje me formimin profesional të studentëve në këtë program studimi dhe kriteret e përcaktuara nga ligji i arsimit të lartë. <u>Sugjerohet që në lëndët bazë të përfshihet 1 lëndë e turizmit të paktën.</u></p> <p><i>Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MHT.</i> <i>Ev. 3_7_ Studimi i tregut të punës për programin e studimit.</i> <i>Ev. 3_4_ Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesi.</i> <i>Ev. 3_9_1 Plani i mësimor i programit të studimit MHT.</i> <i>Ev. 3_3_Plani strategjik i Programit të studimit MHT.</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke</p>	<p>Sikurse u analizua edhe nga diskutimet me drejtuesit e departamenti dhe fakultetit, apo dhe me stafin e këtij program studimi, në lidhje me syllabuset ka rezultuar dhe është dakortësuar se syllabuset në brëndësisinë e tyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kanë shpesh literaturë mjaft të vjetër. Kështu psh lëndët e marketingut (baza dhe drejtim marketing) përmbajnë literaturë të viteve 2008, ndërkohë që marketing është një

<p>përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>fushë që evoluon shumë dhe është në dinamikë të vazhdueshme. Apo edhe rasti i Bazat e turizmit. Musa Gashi. Progres 1986;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ka raste kur ka literaturë të huaj të sugjeruar si literaturë bazë, ndërkohë që ky program është bachelor dhe sugjerohet literaturë në shqip, aq më tepër kur ajo ekziston. Ndërkohë që nga diskutimet me stafin u theksua se ka literaturë në gjuhën shqipe nga autorë dhe ekspertë të fushës; • literaturë bazë e sugjeruar të jetë pothuajse e njëjtë me emërtimin e lëndës. Kështu psh lënda baza turizmi sugjeron si literaturë bazë lëndën sociologjia në turizëm, gjë e cila ve në dyshim formimin e njohurive bazë që jep apo transmeton kjo lëndë shumë e rëndësishëm për këtë program studimi; • syllabuset të jenë sipas VKM nr 41, duke vendosur literaturë dhe nr e faqeve në cdo temë. Kjo gjë vihet re e munguar në shumë raste; • Ka syllabuse pa literaturë në gjuhën shqipe, psh komunikimi; • Të saktësohet referimi i nr te faqeve dhe brendësisë së literaturës bazë për temat e sugjeruara. Rezulton që literatura e sugjeruar të mos përkojë me atë cka konkretisht në brëndësi. Psh citimi i Manaxhimit të Turizmit të Qëndrueshëm si literaturë për temat e para të lëndës së turizmit; <p><i>Ev. _3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. _2_16_ Lista e leksioneve të hapura, trajnimeve dhe ekspertiza e ofruar nga pedagogë të FE për palët e treta.</i></p> <p><i>Ev. _3_7_ Studimi i tregut të punës për programin e studimit.</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit në përgjithësi tregon për përpjekje të stafit për të realizuar dhe garantuar përftimin e dijeve dhe aftësive të studenteve. Megjithatë, garantimi i këtyre dijeve, aftësive dhe kompetencave nuk është në nivele të kënaqshme pasi, sic u përmend edhe në kriterin më sipër, në syllabuse ka literature here herë të papërditësuar dhe sidomos vihen re përplasje midis temave, psh lënda turizëm historic dhe kulturor përmban dy tema që zhvillohen edhe tek guidat turistike. Këto fakte kryesisht bëjnë që të mos zhvillohet niveli i njohurive, i kërkuar në kohët e sotme, aq më tepër kur mungojnë dhe lënde si Turizmi i Qëndrueshëm, Marketingu i turizmit, digjitalizimi në turizëm, etj.</p>




	<p><i>Ev. 3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 2_16_ Lista e leksioneve të hapura, trajnimeve dhe ekspertiza e ofruar nga pedagogë të FE për palët e treta.</i></p> <p><i>Ev. 3_7_ Studimi i tregut të punës për programin e studimit.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Për këtë program studimi është ofruar një dokument që lidhet me studimin e tregut të punës, studim i cili është i përgjithshëm mbi situatë të caktuara apo fotografime të disa momenteve të tregut. Qasja praktike e këtij programi studimi dhe përafrimi i studentëve që në vitin e parë me zhvillimin e orëve mësimore të lëndëve përkatëse në terren ka krijuar dhe do krijojë shanse të mira që studentët e këtij programi studimi të jenë të punësuar.</p> <p><i>Ev. 3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 2_16_ Lista e leksioneve të hapura, trajnimeve dhe ekspertiza e ofruar nga pedagogë të FE për palët e treta.</i></p> <p><i>Ev. 3_7_ Studimi i tregut të punës për programin e studimit.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Ka një qasje drejt tregut për këtë program studimi gjë e cila ka reflektuar me punësim të studentëve dhe me orë praktike që në vitet e para të studentëve.</i></p> <p><i>Ndërkohë që plani mësimor ka nevojë për përmirësime strukturore dhe përmbajtësore të lëndëve dhe syllabuseve përkatëse, të cilat do të sigurojnë dhe certifikojnë faktin se dija dhe njohuria e duhur është transmetuar.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës,</p>	<p>Kolegji Universitar “Qiriazi”, ka realizuar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me Institucione të Arsimit të Lartë, brenda e jashtë vendit, si shtetërore e shoqëri private, për të zhvilluar veprimtari e aktivitete të ndryshme kërkimore, shkencore, promovuese dhe kualifikuese si dhe për realizimin e praktikave dhe mundësinë e punësimit të studentëve për</p>

<p>gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>gjithë programet e studimit në tërësi dhe në veçanti edhe për programin e studimit “Menaxhim Hoteleri- Turizëm”.</p> <p>Në analizën e punës të departamentit DMB, gjatë vitit akademik 2022-2023, janë trajtuar edhe problemet e bashkëpunimit me IAL, institucione shtetërore e firma private dhe përfitimi prej tyre. Kjo do të thotë se departamenti përgjegjës për këtë program studimi analizon dhe mundohet të reflektojë mbi faktin se sa të vlefshme kanë qënë raportet me të tretët dhe se si kanë qënë të reflektuara tek studentët. Mbetet për t’u vlerësuar dhe shpresuar se konsultime eficiente do të kryhen në të ardhmen me ekspertët e fushës apo të përfshihen aktore të tjerë.</p> <p><i>Ev_3_28_ Lista e marrvëshjeve në funksion të programit MHT.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Ka një qasje vecanërisht pozitive nga studentët për KUQ dhe vecanërisht për këtë program studimi. Përgjatë diskutimeve me studentët, u vu re një entuziasëm nga ata në lidhje me përfshirjen e tyre në praktika apo me qasjen praktike të këtij program studimi apo me mbështetjen që KUQ u jep atyre.</p> <p><i>Ev_3_22_ Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njësisë.</i> <i>Ev_2_16_ Lista e leksioneve të hapura dhe trajnimeve.</i> <i>Ev_1_1_ Statuti i (KUQ)</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Nuk ka të dhëna apo të jetë i reflektuar fakti që, që kur është hapur të jenë bërë reflektime në këtë program studimi për shkak të propozimeve apo zhvillimeve si rezultat i bashkëpunimit me të tretët. Ka vetëm një vlerësim mjaft pozitiv për biznesin dhe mbështetjen që ky jep në këtë process, por jo për mbështetjen që aktorët kyc të kenë dhënë dhe të jetë reflektuar në këtë program studimi.</p> <p><i>Ev_3_28_ Lista e marrvëshjeve në funksion të programit MHT.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Ka bashkëpunime eficiente me aktorët e ndryshëm që nga biznesi të cilat janë reflektuar dhe në një raport të vecantë që</i></p>

	<i>departamenti ka gjykuar të prodhojë. Në këtë dokument analizohen në mënyrë të vecantë dhe konkretisht fushat ku janë bashkëpunuar. Por, nuk është bërë ndryshim në program për shkak të sugjerimeve që mund të kenë bërë palët e treta.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Programi i Studimit në Ciklin e Parë Bachelor, “Menaxhim Hoteleri – Turizëm”, në Fakultetin e Ekonomisë me lëndët që ofron, metodat bashkëkohore interaktive që aplikon stafi akademik u jep mundësi pjesëmarrësve që të pozicionohen qartësisht në karrierën e tyre në profilin përkatës. Objektivat kryesore janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - T’i përgatisë studentët për të qnë “liderë të mendimit dhe veprimit”, krzesisht në organizatat e biznesit dhe ato jo-fitimprurëse, por jo vetëm; - T’i përgatisë studentët që të jenë të aftë të pozicionohen në karrierën profesionale, në fushën e hoteleri – turizmit dhe të menaxhimit të biznesit, si në sektorin privat ashtu edhe në atë public; - Të përgatisë dhe formojë specialistë të aftë, të cilët të jenë në gjendje të drejtojnë sipërmarrje të vogla e të mesme në fushën e hoteleri-turizmit, si dhe të kryerjnë role të rëndësishme, në administrimin e shoqërive tregatë e të

	<p>boiznesit, me nivel të lartë në aftësi profesionale dhe përgjegjësi sociale, të aftë t'u përgjigjen sfidave të zhvillimit të shoqërive tregtare në kushtet e konkurrencës rajonale dhe globale;</p> <p><i>Ev. 3_9_1 Plani mësimor i zgjeruar i programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin.</i></p> <p><i>Ev. 2_16_Lista e leskioneve të hapura dhe trajnimeve.</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Në funksion dhe mbështetje të realizimit të këtyre objektivave Departamenti angazhohet për të realizuar mesimin dhe transmetimin e dijeve dhe të njohurive përmes formave të ndryshme, leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. Kjo transmetohet përmes personelit akademik i cili mbështet filozofinë e institucionit për transmetim të dijeve dhe siguron departamentin për të.</p> <p><i>Ev. 3_9_1 Plani mësimor i zgjeruar i programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të ofruara në vitin.</i></p> <p><i>Ev. 2_16_Lista e leskioneve të hapura dhe trajnimeve.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Në mbështetje të personelit akademik, KUQ ka vënë në dispozicion dhe investuar një laborator të tërë për hotelerinë dhe turizmin, madje edhe mësimi shpesh zhvillohej në këtë laborator. Ky laborator mbështet edhe ofrimin e diplomës profesionale ashtu edhe këtë program studimi bachelor. Pavarësisht kësaj, mbështetja e institucionit është e dukshme, kjo u konfirmua edhe përgjatë takimit me njësinë e sigurimit të cilësisë apo të zyrës së projekteve sikundër u reflektua mbështetja edhe financiare që i jepet stafit akademik për të përdorur një fond të caktuar për kërkimin shkencor.</p> <p><i>Ev. 3_6_Rregullore e programit të studimit të MHT.</i></p> <p><i>Ev. 1_19_Udhëzues për përdorimin e platformave të mësimdhënies.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në</p>	<p>Përgjatë vizitës në institucion në takimin me stafin mësimdhënës në këtë program studimi, u vu re një prani e profesorëve me experiencë të gjatë të përfshirë në mësimdhënien e lëndëve ekonomike dhe të tjera, por jo në</p>

<p>shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>lidhje me turizmin. Nuk ishin të pranishëm një pjesë e mirë e pedagogëve që japin mësim në lëndët e turizmit.</p> <p>Profesorët e lëndëve ekonomike, të financave kontabilitetit matematikës apo sigurisë ushqimore dhe marketingut u treguan shumë aktiv dhe mbështetës në metodat mësimdhënëse dhe përfshirjen e studentëve. Ndërkohë që u diskutuan të gjitha problematikat dhe u dakortësuan për të zhvilluar më tej këtë program studimi edhe përmes cilësisë së stafit mësimdhënës në lëndët bazë dhe mbështetëse të turizmit.</p> <p><i>Ev. 3_11_Stafi akademik që jep mësim në programin e studimit në MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_12_CV-të e stafit akademik që japin mësim, në programin e studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_24_Konferenca IPE me pjesëmarrje Staf Akademik dhe student.</i></p> <p><i>Ev. 3_32_Instrumenta te Monitorimit te Cilësisë.</i></p> <p><i>Ev. 1_5_2_Raport vjetor i Njësisë së Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) viti akade-mik 2021-2022.</i></p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti i KUQ.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Përgjatë vizitës në institucion, u vu re një përfshirje shumë aktive e drejtuesit të njësisë bazë, të departamentit në të gjithë procesin e vizitës në institucion, e reflektuar me një qasje mbështetëse, dakortësuese dhe positive ndaj procesit. Mënyrat tradicionale të mësimdhënies gjatë kohës së studimit shoqërohen edhe me qasje të tjera konstruktiviste, si ushtrimet praktike, detyra kursi, punimet e pavarura, punime në grup, studime rasti, problem solving etj. Në disa nga lëndët pedagogët përdorin materiale audiovizuale gjatë orës së mësimi për t'iu paraqitur studentëve situata reale, të cilat i diskutojnë me studentët duke nxitur analizën.</p> <p><i>Ev. 3_18_Pyetësorët e studentëve.</i></p> <p><i>Ev. 3_22_Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njësisë.</i></p> <p><i>Ev. 3_32_Instrumenta te Monitorimit te Cilësisë.</i></p> <p><i>Ev. 1_5_2_Raport vjetor i Njësisë së Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) viti akade-mik 2021-2022.</i></p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti i KUQ.</i></p> <p><i>Ev. 2_16_Lista e leskioneve të hapura dhe trajnimeve.</i></p> <p><i>Ev. 3_32_Instrumenta te Monitorimit te Cilësisë.</i></p>




	<i>EV. 1_5_2 Raport vjetor i Njesisë së Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) viti akademik 2022-2023.</i>			
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	<p>Departamenti i “Menaxhimit të Biznesit”, në bashkëpunim me strukturat e ngritura, në veçanti “NJSBC”, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces. Vlerësimi periodik i procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies realizohet me përfshirjen direkte të studentëve nëpërmjet instrumentave që njësia përdor.</p> <p>Institucioni tregon një kujdes të vecantë në trajnimin e vazhdueshëm të personelit akademik për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie dhe në aktivitetet e tjera ku personeli angazhohet. Institucioni organizon trajnimin e pedagogëve sipas nevojave dhe nivelit të kualifikimit të secilit, në drejtime si: metodat e mësimdhënies, ino-vacionet në sektore të ndryshëm, njohja e kuadrit rregullator të institucionit brenda kornizës së arsimit të lartë.</p> <p><i>Ev. 3_18_Pyetësorët e studentëve.</i></p> <p><i>Ev. 3_22_Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njesisë.</i></p> <p><i>Ev. 3_32_Instrumenta te Monitorimit te Cilësisë.</i></p> <p><i>EV. 1_5_2 Raport vjetor i Njesisë së Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) viti akademik 2021-2022.</i></p> <p><i>Ev. 1_1 Statuti i KUQ.</i></p> <p><i>Ev. 2_16_Lista e leskioneve të hapura dhe trajnimeve.</i></p> <p><i>Ev. 3_32_Instrumenta te Monitorimit te Cilësisë.</i></p> <p><i>EV. 1_5_2 Raport vjetor i Njesisë së Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) viti akademik 2022-2023.</i></p>			
Konkluzione	<i>Njësia bazë, Departamenti siguron mbështetjen për stafin për të siguruar jo vetëm motivimin e tyre por përfshirjen në metoda mësidhënese të reja dhe active. Njësia e sigurimit të cilësisë është mjaft e përfshirë në këtë process dhe nga KUQ ofrohet një mbështetje e vazhduar për stafin në të gjitha drejtimet duke u munduar tu sigurohet atyre edhe mbështetje për kërkimin shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Rregullorja e Programit të Studimit në Ciklin e Parë, Bachelor në “Menaxhim Hoteleri – Turizëm”, në Fakultetin e Ekonomisë, Kolegji Universitar “Qiriazi”, është mbështetur në: Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe ne cdo udhëzim të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Rregullorja e Programit të Studimit në Ciklin e Parë, Bachelor në “Menaxhim Hoteleri – Turizëm”, në Fakultetin e Ekonomisë, Kolegji Universitar “Qiriazi”, përcakton objektivat e programit të studimit, parimet, mënyrën e funksionimit të këtij programi, rregullat për pranimin e studentëve, mësimdhënien, praktikën, vlerësimin, diplomën dhe transferimin e studentëve.</p> <p><i>Ev. 3_6_Rregullore e programit të studimit të MHT.</i> <i>Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MHT.</i> <i>Ev. 3_2_Dosja e programit të studimit Bach, MHT.</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në kreun 3, te rregullores se programit te studimit, “Kontrolli dhe Vlerësimi I dijes”, perkatesisht neni 13: “Elementët dhe sistemi i vlerësimit”, përcaktohen kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive. Pedagogët që zhvillojnë lëndët/modulet në orët e para të procesit mësimor u vënë në dijeni studentëve mjetet dhe instrumentet me të cilat ata demonstrojnë përvetësimin e objektivave formuese dhe të kompetencave profesionale të pro-gramit studimit Bachelor në “MHT”.</p> <p><i>Ev. 3_6_Rregullore e programit të studimit të MHT.</i> <i>Ev. 3_14_Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MHT.</i> <i>Ev. 3_2_Dosja e programit të studimit Bach, MHT.</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke</p>	<p>Ne rregulloren e ketij programi studimi percaktohet se kontrolli i dijes së një lënde bëhet me provim, i cili realizohet me shkrim. Mënyrat e kontrollit të dijes përcaktohen në syllabuset e lëndëve/moduleve të miratuara nga departamentet përkatëse dhe paraqiten në planet mësimore të çdo programi studimor.</p>




<p>i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>(Neni 14 Mënyrat e kontrollit të dijes). Vleresimi i studentit me notë realizohet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrje, 10%; - Provimi i Ndërmjetëm, 20%; - Detyra e Kursit, 10%; - Provimi Përfundimtar, 60%; <p><i>Ev. 3_6 Rregullore e programit të studimit të MHT.</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Ekziston një përpjekje nga NJSBC për të përmirësuar procesin dhe përfshirjen të gjithë aktorët në këtë proces, vecanërisht stafin mësimdhënës. Si pjese e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësive, Kolegji Universitar “Qiriazi”, zhvillon dhe përmirëson format e mesimdhënies. Si në dokumentet kryesore ashtu edhe në dokumentet e lidhura konkretisht me cilësinë e mesimdhënies sic është “Manuali I cilësive”, në përmirësimin e këtyre formave dhe metodave ndikojnë edhe studentet, nëpërmjet diskutimeve në klase mbi përparësitë e programit apo dhe problematikat në secilen lende, si dhe nëpërmjet realizimit të pyetësoreve për studentet.</p> <p><i>Ev. 3_18 Pyetësor për Pedagogun.</i> <i>Ev. 1_6 Manuali i Cilësisë së KUQ.</i> <i>Ev. 3_22 Aktivizimi i studentëve në mbledhje të njësive.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e</p>	<p>Në Nenin 23 të Rregullores së programit të studimit përcaktohet Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë, ku identifikohen se rezultatet dhe niveli cilësor i aktiviteteve formuese të zhvilluara në këtë program studimi të Ciklit të Parë vlerësohet çdo vit, në përfundim të tij, sipas modaliteteve të përcaktuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ky vlerësim shërben si bazë për vazhdimësinë e programit të studimit në vitin e ardhshëm. “MHT”, karakterizohet nga një komunikim etik dhe profesional. Një vlerë e shtuar në këtë proces është informacioni i marrë nga pyetësorët drejtuar studentëve në lidhje me programin respektiv të tyre dhe roli i dijeve të përvetësuara për integrimin e tyre në tregun e punës.</p> <p><i>Ev. 3_14 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MHT.</i> <i>Ev. 3_18 Pyetësorët e studentëve.</i> <i>Ev. 3_25 Lista e leksioneve të hapura dhe trajnimeve.</i></p>




marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<i>Ev. 3_24 Konferenca IPE me pjesëmarrje Staf akademik dhe student.</i>			
Konkluzione	<i>Nga institucioni KUQ, përmes njësive të sigurimit të brëndshëm të cilësisë, të implementuar edhe përmes rregulloreve të programit të studimit, manualit të cilësisë, pyetësorëve të studentëve, dhe të dokumentave të tjerë shoqeruese, vihet re një qasje positive dhe mbështetese per cilesine e mesimdhënieve dhe per standartizimin e procesit te vleresimit te studenteve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Testimi i njohurive të studentëve është përcaktuar qartë në dokumentat shoqeruese dhe mbështetese te ketij programi studimi, dhe përbën një proces që realizohet i shtrirë përgjatë semestrit ose vitit, sipas lëndës/modulit. Aktet rregullative të “FE” përcaktojnë se si realizohet ai nëpërmjet disa komponentëve: angazhimit në diskutime gjatë seminareve dhe me detyra të kontrolluara përgjatë zhvillimit të lëndës; detyrave të kursit për problematikën e disiplinës; provimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara gjatë zhvillimit të lëndës.</p> <p>Në nenin 13, elementët dhe sistemi i vlerësimit përcaktohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: vlerësimi i vazhdueshëm gjatë vitit për elementet e përcaktuara në programin e disiplinës/modulit dhe, vlerësimi përfundimtar. Kjo gjë u bëhet e ditur studentëve në orën e parë të zhvillimit të mësimin nga ana e pedagogut; - Vlerësimi i vazhdueshëm gjatë semestrit deri në provimin përfundimtar vjetor do të shpallet para fillimit të sezonit të provimeve nga pedagogu i seminareve për çdo student. Ai është i ndarë për rubrika të ndryshme dhe në masën e përcaktuar në programin e çdo lënde/ syllabus, të miratuara nga departamenti (et); - Vlerësimi përfundimtar është ai që konsideron vlerësimin e vazhdueshëm dhe vlerësimin e provimit të zhvilluar për

	<p>lëndën, në përfundim të semestrit. Vlerësimi përfundimtar me pikë dhe nota përkatëse, pas realizimit të provimit, përfshirë edhe pikët e vlerësimit në testet e zhvilluara dhe në pjesëmarrjen aktive në leksione dhe seminare gjatë vitit është i percaktuar qarte;</p> <p><i>Ev. 1_19 Udhëzues për përdorimin e platformave të mësimdhënies.</i></p> <p><i>Ev. 3_14 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 2_3 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p> <p><i>Ev. 3_4 Rregullore e Departamentit të Menaxhimi Biznesit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Si nga vizita ne institucion ashtu edhe nga dokumentacioni vihet re se pedagoget jane te mundur dhe te nxitur te vene ne zbatim platforma elektronike te ofruara pa pagese ne menyre publike, sic eshte google classroom, nga ku mund te perdoren dhe metoda elektronike te vleresimit dhe testimit.</p> <p><i>Ev. 1_19 Udhëzues për përdorimin e platformave të mësimdhënies.</i></p> <p><i>Ev. 3_14 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 2_3 Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p> <p><i>Ev. 3_4 Rregullore e Departamentit të Menaxhimi Biznesit.</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Ne syllabuset e lendeve, te ndertuara sipas formatit te VKM 41, mund te shihet qarte se jane te shprehura vleresimet qe cojne ne vleresimin perfundimtar te lendes, conform edhe rregullores se programit te studimit. Nga evidentimi I disa procesverbaleve ne sekretarine mesimore u vu re se zbatohet syllabusi dhe baza ligjore ne fuqi per vendosjen e vleresimeve.</p> <p><i>Ev. 3_6 Rregullore e programit të studimit të MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_14 Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MHT.</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të</p>	<p>E detajuar edhe në rregullore por edhe e shpjeguar gjatë vizites në institucion, problemet e ndryshme te konstatuara pergjate procesit te mesimdhënies/mesimnxënies zgjidhen nga pedagogu nepermjet këshillimit apo sqarimit studentin si dhe ofrimit të gjithë informacionit te duhur, si në tezë si dhe për përmirësim në të ardhmen.</p> <p><i>Ev. 3_6 Rregullore e programit të studimit të MHT.</i></p>



përmirësohet në të ardhmen.	<i>Ev. 3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MHT.</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	<p>Ka nje procedure qe institucionalizon afatet e dorezimit ne kohe sit e vleresimeve apo ankimimeve. Studentet u shprehen se nuk kane patur probleme apo paqartesi ne kete drejtim.</p> <p>Keshilli I etikes shqyrton dhe raporton ceshtje me rendesi si plagjiatura kopjimi ne provime dhe punimet e kursit, te cilat konsiderohen shkelje nga pikepamja e rregulloreve te institucionit.</p> <p>Gjtihashtu rregulloret parashikojne edhe masa ndaj personave qe kryejne veprime te tilla, qe nga verjtjet verbale, e deri ne perjashtim , duke u nisur nga rendesia dhe shkalla e thyerjes se rregullit dhe ndikimi I tij.</p> <p><i>Ev. 3_6_Rregullore e programit të studimit të MHT.</i></p> <p><i>Ev. 1_8_Rregullore e Këshillit të Etikës.</i></p>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>Sipas vizites në institucion, si nga diskutimi me studentet ashtu dhe me pedagoget e programit, duket qarte që palet janë të angazhuar për të arritur dhe vendosur vleresime sipas njohurive dhe dijeve. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> <p><i>Ev. 3_6_Rregullore e programit të studimit të MHT.</i></p> <p><i>Ev. 1_8_Rregullore e Këshillit të Etikës.</i></p>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	<p>Vlerësimi për rezultatin paraprak të provimit iu bëhet i ditur studentëve nëpërmjet sekretarisë mësimore. Ne rregulloren e ketij programi studimi specifikohet ne nenin 18 procesi i ankimimit. Studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin me notë nga komisioni i provimit. Ankimimi bëhet me shkrim brenda dy ditëve nga data e dhënies së provimit.</p> <p><i>EV. 3_4_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit.</i></p> <p><i>Ev. 3_2_Rregullore e programit të studimit të MHT.</i></p>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i	<p>Ankimimi i studentit shqyrtohet nga një komision i kryesuar nga Drejtuesi i Departamentit brenda të njëjtit sezon provimesh. Procedura e ndjekur eshte transparente, duke u</p>




posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	dokumentuar dhe arkivuar, sipas rregullore së departamentit dhe asaj të programit të studimit. <i>EV. 3_4_ Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit.</i> <i>Ev. 3_2_ Rregullore e programit të studimit të MHT.</i>		
Konkluzione	<i>Procesi i vleresimit te studenteve, dhenia e vleresimeve dhe ankimimi jane procedura te rregulluara me dokumentat perkates. Keto u konfirmuan edhe nga studentet.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Të gjitha dokumentat strategjike që nga Statusi deri tek rregulloret e këtij departamenti për këtë program studimi kujdesen që të jetë në vëmendje garantimi i thellimit të njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. Programi ben perpjekje te bira per te zbatuar arritjet me te mira ne fushen perkatese te dijes, turizmin, duke perfshire praktikat profesionale te pershtatura me kerkesat e tregut te punes si dhe me partnered te cilet KUQ ka bashkepunim. <i>Ev. 3_3_ Plani strategjik i Programit të studimit MHT.</i> <i>Ev. 3_28_ Lista e marrvëveshjeve në funksion të programit MHT.</i> <i>Ev. 3_25_ Lista e leksioneve të hapura dhe trajnimeve.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Përmes lëndëve të vecanta të përfshira në planin mësimor bëhet një përpjekje e këtij departamenti për të garantuar zhvillimin e aftësive të vecanta në fushën e teknologjise, informacionit, etj. Në fakt, sikurse është përmendur edhe në pjesen e syllabuseve me pare, nje nder sugjerimet qe i shkojne ketij program studimi per permiresime te mundshme te ne ardhmen lidhet me pranine e lendeve te e-turizmit ne kete plan mesimor, apo pranine e lendeve inovative ne shporten e lendeve me zgjedhje, sikurse

	<p>sugjerohet anglishtja ne turizem per te siguruar nje body language apo komunikimet ne turizem si lende e dedikuar komunikimit ne turizem, apo edhe marketing i turizmit te sugjeruara heret.</p> <p><i>Ev. 3_9_1 Plani mësimor i zgjeruar i programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_9_2 Kredite sipas veprimtarive formuse të programit të studimit MHT.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Problematikat qe kane shfaqur syllabuset se bashku me kompozimin e planit mesimor te ketij program studimi pengojne faktin qe kompetencat dhe aftesite e duhura jo vetem te transmetohen por edhe te analizohen mire ne fund tec do lende. Per shkak te perplasjeve te temave <i>Brenda syllabuseve te ndryshme, <u>eshte sugjeruar fort</u> edhe pergjate vizites ne institucion qe analiza dhe diskutime te shumta duhet te behen ne te ardhmen midis stafit mesimdhenees per te diskutar cdo element te syllabusit, qe nga objektivat, temat dhe si keto nderidhen me njeri tjetrin, per te finalizuar transmetinin e dijeve te qarta dhe te sakte.</i></p> <p><i>Ev. 3_14_ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MHT.</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e</p>	<p>Një ndër elementet që u identifikua lidhet me faktin se nuk ekziston një qasje active nga stafi brëndshëm për të rritur kërkimin shkencor përmes përdorimit të fondeve të vecanta që KUQ ka vënë në dispozicion të stafit.</p> <p>Ne programin e studimit jane perfshire ne mesimdhenie ekspertize e nenfushave ekonomike, financiare, megjithate duke qene se ky porogram eshte ne fushen hoteleri turizem, duhet qe me teper ekspertize nga kjo fushe dhe nenfushat e saj te jene prezente ne program. Gjithsesi nga vizitat ne institucion me pedagoge te programit te studimit dhe studentet ne ato fusha ku ka ekspertize ne turizem, ju jepet zgjidhje problemeve dhe rasteve, por duhet te kete me teper kerkim te fokusuar drejt turizmit. Gjithashtu institucioni ka bashkepunime me operatore ne fushen e turizmit porn ga pyetjet lidhur me mbarevajtjen e studenteve dhe praktikat del se duhen bere me teper perpjekje qe te perdoren keto marredhenie dhe marreveshje per rritjen e studenteve ne rrugen e tyre drejt tregut te punes</p>




<p>mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p><i>Ev. 3_9_1 Plani mësimor i programit të studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_28_ Lista e marrëveshjeve në funksion të programit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_21_ Vendimi i Senatit Akademik për ndarjen e fondit të kërkimit shkencor miratuar me vendim Bordi.</i></p> <p><i>Ev. 3_29_ Raporti i fundit i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit për programin e studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_25_ Projekti në kuadër të programit Erasmus, HUB Bolonja.</i></p> <p><i>Ev. 3_24_ Konferenca IPE me pjesëmarrje Staf Akademik dhe student.</i></p> <p><i>Ev. 3_26_ Mobilitete me Universitetet e Jaen-it në Spanjë dhe Azerbajxhanit.</i></p>		
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Gjykuar mbi bazën e një dokumenti që përmbledh listen e leksioneve të hapura dhe trainimeve, rezulton një përpjekje positive për këtë fat. Por edhe qasja e fortë ndaj tregut e bënë të hapur këtë department ndaj tregut.</p> <p><i>Ev. 3_25_ Lista e leksioneve të hapura dhe trajnimeve.</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni KUQ ben perpjekje te dukshme nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit. Gjykohet se një përpjekje më e madhe duhet të bëhet nga stafi për 'tu përfshire në kërkimin shkencor si dhe të sigurohet transmetimi i dijeve të duhura përmes reflektimit të problematikave të identifikuar në syllabuse të cilat garantojnë dijet e duhura.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Standardi III.5</p>	
<p>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar</p>	<p>Provimi i përgjithshëm përfundimtar apo punimi i diplomes janë alterantivat për diplomimin e studenteve në fund të tre</p>




<p>ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>viteve te studimit dhe jane kriter per diplomim, bazuar ne rregulloren e Departamentit “Menaxhim Biznesi”.</p> <p>Rregullorja e programit te studimit si dhe rregulloret e fakultetit dhe departamentit percaktojne procedure e detajuar per diplomim, qe perfshin edhe kriteret perkatese te ndarjes se studenteve sipas formave te provimit perfundimtar. Nje liste e fushave ku do te zhvillohen temat e diplomave percaktohet nga departamenti.</p> <p><i>Ev. 3_4_Rregullore e Departamentit Menaxhimit të Biznesit.</i></p> <p><i>Ev. 3_6_Rregullore e programit të studimit të MHT.</i></p> <p><i>Ev. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>Ev. 3_4_1_Rregullore e diplomimit.</i></p> <p><i>Ev. 3_23_Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese.</i></p> <p><i>Ev. 3_28_Pyetjet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP).</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Procesi i realizimit të diplomimit afishohet në këndin e njoftimeve të KUQ.</p> <p>Sic u permend edhe ne kriterin 1 me lart, nje liste e temave me rendesi te percaktuara nga departamenti u vihet ne dispozicion studeteneve qe kane plotesuar kriterin per permbushjen e detyrimit me teme diplome. Pasi student perzgjedh temen, atij I caktohet dhe nje pedagog udheheqes qe monitoron dhe mbeshtet studeitn deri ne perfundim te procesit dhe dorezim te punimit te tij ne department. Studentet mund te perdorin materialet e bibliotekes, si dhe mbeshteten nga pedagogu udheheqes ne seleksionimin e literaturave perkatese.</p> <p><i>Ev. 3_4_Rregullore e Departamentit Menaxhimit të Biznesit.</i></p> <p><i>Ev. 3_6_Rregullore e programit të studimit të MHT.</i></p> <p><i>Ev. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë</i></p> <p><i>Ev. 3_4_1_Rregullore e diplomimit.</i></p> <p><i>Ev. 3_23_Fushat e ekspertizës dhe temat orientuese.</i></p> <p><i>Ev. 3_28_Pyetjet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP).</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e</p>	<p>Të gjitha këto procese janë të mirpërcaktuara, shprehura qartë dhe në rrjedhe të njëra tjetrës qartë dhe sakte në rregulloren e</p>

<p>njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>departamentit për këtë program studimi, por edhe në dokumentat strategjike të KUQ.</p> <p><i>Ev. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p> <p><i>Ev. 3_23_Pyetjet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP).</i></p> <p><i>Ev. 3_11_Stafi akademik që jep mësim në programin e studimit në MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_2_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit.</i></p> <p><i>Ev. 3_4_Rregullore e programit të studimit të MB.</i></p> <p><i>Ev. 3_4_1_Rregullore e diplomimit.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Njësia bazë është përgjegjëse për mbarëvajtjen e gjithë procesit të diplomimit. Në fillim të vitit të tretë studentëve ju vendoset në dispozicion programi orientues për provimin përfundimtar. Programi i Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga stafi i njësisë bazë, miratohet nga Drejtuesi i Departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit.</p> <p><i>Ev. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p> <p><i>Ev. 3_23_Pyetjet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar (PPP).</i></p> <p><i>Ev. 3_11_Stafi akademik që jep mësim në programin e studimit në MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_2_Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit.</i></p> <p><i>Ev. 3_4_Rregullore e programit të studimit të MB.</i></p> <p><i>Ev. 3_4_1_Rregullore e diplomimit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Njësia bazë që ofron këtë program studimi ka një qasje mbështetëse dhe pozitive për studentet edhe për procesin. Kjo njësi asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> <p>Departamenti dhe pedagogët e programit të studimit I nxisin studentet për të punuar me literaturën e duhur dhe për metodologjinë në vëzhgime e anketime në mjedisin e biznesit në fushën e turizmit, kur nevojiten të tilla. Gjithashtu edhe</p>




	<p>mjediset e KUQ jane ne sherbim te studenteve me qëllim mbështetjen e punës së tyre studimore.</p> <p><i>Ev. 3_11_ Stafit akademik që jep mësim në programin e studimit në MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit.</i></p> <p><i>Ev. 3_4_1_ Rregullore e diplomimit</i></p> <p><i>Ev. 2_3_ Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p> <p><i>Ev. 3_4_ Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit.</i></p> <p><i>Ev. 3_6_ Rregullore e programit të studimit të MHT.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sipas rregulloreve të departamentit dhe fakultetit dhe institucionit, mbrojtja e diplomes, qofte me teme qofte me provim vlerësohet me note dhe nota është pjesë e listës përfundimtare të notave të studentit në përfundim të studimeve. Ky vlerësim vendoset nga komisioni I posaçem I ngritur për mbrojtjen e diplomes I përbërë nga 3 anëtarë, pedagogë që japin mesim në programin e studimit. Departamenti propozon anëtarët e komisionit të cilët miratohen nga Dekani i Fakultetit të Ekonomisë. Kryetari i komisionit kryesisht është Drejtuesi i Departamentit.</p> <p><i>Ev. 3_2_ Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit.</i></p> <p><i>Ev. 3_4_1_ Rregullore e diplomimit</i></p> <p><i>Ev. 2_3_ Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p> <p><i>Ev. 3_4_ Rregullore e Departamentit të Menaxhimit të Biznesit.</i></p> <p><i>Ev. 3_6_ Rregullore e programit të studimit të MHT.</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Sipas rregulloreve të arkivës, të sekretarisë mesimore dhe të programit të studimit, student pasi përfundon studimet bën një kërkesë pranë sekretarisë mesimore dhe ka të drejtë të marrë kopjen e firmosur dhe vulosur të programit të fjalës të studimit, suplementi I diplomes dhe diploma. Programi I studimit së bashku me syllabuset përkatëse i vihet në dispozicion studentit sipas kërkesës dhe brenda afatëve të përcaktuara në rregullore.</p> <p><i>Ev. 1_6_ Rregullore e zyrës së Burimeve Njerëzore dhe e Protokoll-Arkivit.</i></p>




	<p><i>An. 1_12_Rregullore e Sekretarisë Mësimore.</i></p> <p><i>Ev. 3_17_Model i diplomës për programin e studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_17_1_Model suplementit për programin e studimit në MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_6_Rregullore e programit të studimit të MHT.</i></p> <p><i>Ev. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Dokumentacioni I studentit qe nga momenti i regjistrimit ruhet fizikisht dhe elektronikisht ne nje dosje individuale ne sekretarine mësimore të studentit. Kjo sekretari permes personelit te saj ruan dhe perpunon te dhena nga dosjet duke menaxhuar keshtu dosjen e studentit, deri ne perfundim te studimeve.</p> <p><i>Ev. 1_6_Rregullore e zyrës së Burimeve Njerëzore dhe e Protokoll-Arkivit.</i></p> <p><i>An. 1_12_Rregullore e Sekretarisë Mësimore.</i></p> <p><i>Ev. 3_17_Model i diplomës për programin e studimit MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_17_1_Model suplementit për programin e studimit në MHT.</i></p> <p><i>Ev. 3_6_Rregullore e programit të studimit të MHT.</i></p> <p><i>Ev. 2_3_Rregullore e Fakultetit të Ekonomisë.</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ben te gjitha perpjekjet per te siguruar procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Kete process e ka institucionalizuar ehde perms rregulloreve perkatese qe nga statuti i KUQ deri tek rregullorja e ketij program studimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Kërkesat ligjore në fuqi për stafin akademik përcaktohen me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në zbatim të tij si dhe të Statutit të KUQ dhe Rregullores, përbërja e stafit akademik është e tillë që përmban staf me titullin minimal Master shkencor.</p> <p>Në këtë program studimi, referuar <i>Evidenca 28 Tabelat per stafin akademik.</i>, të dhënat për stafin e angazhuar për mësimdhënie gjatë tre viteve akademike paraqiten si vijon:</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022 janë të angazhuar 11 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 10 PAE, nga të cilët 2 me titullin “Profesor”, 1 me titullin “Profesor i Asocuar” dhe 3 me gradën “Doktor” dhe 4 me Msc; • 1 PAK, me titullin “Profesor i Asocuar”; <p>Ky program studimi për këtë vit akademik është mbuluar në nivelin 90% nga PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2022-2023 janë të angazhuar 18 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 16 PAE, nga të cilët 4 me titullin “Profesor”, 2 me titullin “Profesor i Asocuar” dhe 5 me gradën “Doktor” dhe 5 me Msc; • 2 PAK, 1 me titullin “Profesor i Asocuar” dhe 1 me gradën “Doktor”; <p>Ky program studimi për këtë vit akademik është mbuluar në nivelin 88.8% nga PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2023-2024 janë të angazhuar 22 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 20 PAE, nga të cilët 4 me titullin “Profesor”, 2 me titullin “Profesor i Asocuar” dhe 6 me gradën “Doktor” dhe 8 me Msc; • 2 PAK, 1 me titullin “Profesor i Asocuar” dhe 1 me gradën “Doktor”; <p>Ky program studimi për këtë vit akademik është mbuluar në nivelin 90% nga PAE.</p>




	Kualifikimi i stafit është si më poshtë vijon:																									
	2021-2022		2022-2023		2023-2024																					
Grada/tituj	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																				
Prof.Dr.	2	-	4	-	4	-																				
Prof.Asoc.	1	1	2	1	2	1																				
Dr./PhD	3	-	5	1	6	1																				
MSc	4	-	5	-	8	-																				
Total	10	1	16	2	20	2																				
	<i>Ev_Lista e stafit akademik qe zhvillojne mesim ne programin MHT</i>																									
	<i>EV. 3_10 Stafit akademik</i>																									
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	<p>Bazuar në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Udhëzimet e MAS, Rregulloret dhe statuti i KUQ, përgatitet në mënyrë të përvitshme, ngarkesa e stafit akademik, në çdo fillim viti akademik nga Departamenti dhe përgjegjësi i departamentit. Ngarkesa propozohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe miratohet duke u bazuar në legjislacionin në fuqi. Personeli akademik efektiv mbulon 70% të ngarkesës. Ngarkesa e stafit përcaktohet bazuar mbi titujt akademikë dhe gjithashtu udhëzimet dhe rregulloret për orët e zhvilluara mbi normë, të cilat nuk mund të jenë më shumë se 200 orë dhe në raste të vecanta me propozim të drejtuesit të njësisë bazë dhe miratim të drejtuesit të njësisë kryesore, mund të jetë edhe 100 orë më tepër.</p> <p>Numri dhe raporti i orëve mësimore të realizuara nga stafet akademike PAE / PAK në tre vitet e fundit akademike sipas (Evidenca 28 Tabelat per stafin akademik jepet në vijim:</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>21-22</td> <td>660</td> <td>585</td> <td>75</td> <td>88.6 % / 11.4%</td> </tr> <tr> <td>22-23</td> <td>1380</td> <td>1245</td> <td>135</td> <td>90% / 10 %</td> </tr> <tr> <td>23-24</td> <td>1860</td> <td>1635</td> <td>225</td> <td>87% / 13%</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i></p> <p><i>Ev_Lista e stafit akademik qe zhvillojne mesim ne programin MHT</i></p>						Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	21-22	660	585	75	88.6 % / 11.4%	22-23	1380	1245	135	90% / 10 %	23-24	1860	1635	225	87% / 13%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																						
21-22	660	585	75	88.6 % / 11.4%																						
22-23	1380	1245	135	90% / 10 %																						
23-24	1860	1635	225	87% / 13%																						
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë	Stafi i departamentit dhe i programit të studimit është relativisht i qëndrueshëm, për disa vite. Gjithë stafi akademik është i punësuar me kontratë të përhershme ose të përkohshme																									

<p>e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>sipas kategorive dhe kushteve të departamentit dhe programit të studimit. Vihet re se në disa lëndë specifike të programit të lidhura me fushën e studimit ato mbulojnë nga të njëjtët pedagogë, gjë që duhet të mbahet parasysh në rekrutimet e mëtejshme apo synimin për lëndët e specialitetit të turizmit.</p> <p>Kontratat e punësimit dhe mbulimi me sigurime shoqërore dhe shëndetësore realizohen duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, duke përfshirë Ligjin për arsimin e lartë, 80/25 dhe Ligjin për Sigurimet Shoqërore në RSH si edhe Kodin e punës, sipas të cilave bëhet edhe përlogaritja e deklarimeve të të gjitha kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punonjësve. Procedurat për rekrutimin e personelit akademik në përgjithësi si dhe për programin e studimit dhe përfshijnë kontratat e punësimit si PAE ose si PAK, të cilat u evidentuan edhe nga vizita në terren.</p> <p><i>Ev_Lista e stafit akademik qe zhvillojne mesim ne programin MHT</i></p> <p><i>Ev. 1_13_Rregullore e ZBNJ dhe procedura</i></p> <p><i>Vizita në institucion, në Zyrën e burimeve Njerëzore</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>KUQ ka hartuar “Rregulloren e ZBNJ dhe procedurat”, e cila bazohet në Ligjin 80/2015 për Arsimin e Lartë, Kodin e Punës në RSH, statutin dhe rregulloren e KUQ. Evidentimi i nevojave për personel akademik si dhe ndihmës akademik e administrative vjen si kërkesë nga departamentet përkatëse dhe bëhet cdo fillim viti sipas nevojave përkatëse, kjo pasqyrohet edhe në rregulloren e departamentit (neni 9). Vëndet vakante shpallen në web-siten e Universitetit. Departamenti i Menaxhimit të biznesit ka hartuar dhe kritere specifike për pranimin e stafit akademik, sipas nevojave, kur ka qenë praktika e duhur, si dhe ka hartuar kritere preferuese apo plotësuese.</p> <p>Për ndjekjen e gjithë procedurës lidhur me plotësimin e vendeve vakante ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore. Procedura e verifikuar nga dokumentacionet mbështetëse dhe nga vizita në institucion përfshin disa hapa të rëndësishme që nga shpallja e pozicionit të lirë për publikun në mediat përkatëse dhe web, përshkrimin e pozicionit, kriteret e përgjithshme të pranimit, dokumentat për aplikim, ngritjen e komisionit të posacëm, intervistën përpara komisionit, vlerësimin e kandidatit dhe vendimi për aplikantin fitues.</p>

	<p>Procedurat, afatet e dorëzimit të dokumentacionit, procedura e konkurrimit, rezultatet, afatet e ankimit janë objekt i rregullores së Universitetit si edhe Rregullores së burimeve njerëzore, dhe procedurat, sic u përmend edhe më lart.</p> <p><i>Ev. 1_1_ Statuti KUQ</i></p> <p><i>Ev. 1_4_ Rregullore e Kolegjit</i></p> <p>EV.3_4_ RREGULLORE DEPARTAMENTI</p> <p><i>Ev. 1_13_ Rregullore e ZBNJ dhe protokollit dhe Arkivit</i></p> <p><i>Vizita në institucion, në Zyrën e burimeve Njerëzore.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në statutin e KUQ, neni 31, përcakton rolin, kategoritë dhe detyrat e personelit ndihmës akademik, punësimi i të cilit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përcaktohen orientimet gjithashtu në këtë nen në pikën 2 dhe 3 të tij. Personeli ndihmës akademik i angazhuar në Departamentin e menaxhimit të biznesit dhe përkatësisht në këtë program studimi është i angazhuar për mbështetjen e stafit akademik në funksion të programit të studimit, si dhe në orët e laboratoreve duke patur parasysh edhe specifikën e programit me orë praktike të cilat zhvillohen në laboratorin e pajisur me elementet e akomodimit, operacionet e ushqimit dhe pijeve, hapësirat e receptionit dhe mjedis mësimor, ku janë të nevojshme mbështetja e personelit mbështetës.</p> <p><i>Ev. 1_1_ Statuti KUQ</i></p> <p><i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe</p>	<p>Dokumentacioni lidhur me personelin e institucionit, përfshirë personelin akademik dhe atë administrativ e ndihmës akademik, menaxhohet nga drejtoria e menaxhimit të Burimeve njerëzore. Ajo menaxhon dosjet personale të të gjithë punonjësve, duke përfshirë ata me kontratë të përhershme efektive dhe ata me kontratë të përkohshme të personelit të jashtëm. Dosja përmban dokumentacionin personal të çdo punonjësi, librezën e punës dhe ndryshimet në dosje për shkak të zhvillimit të karrierës dëshmitë e kualifikimeve të mëtejshme të stafit. Nga vizita në zyrën e burimeve njerëzore, u evidentuan mbajtja e të dhënave dhe dosjeve me të gjithë elementët, duke bërë një përzgjedhje me dy anëtarë të stafit dhe u pa saktësia e mbajtjes së informacionit për stafin. Drejtoria e burimeve njerëzore është</p>



<p>vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit të përditësuar për secalin anëtar të stafit.</p> <p><i>Ev. 1_13_ Rregullore e ZBNJ dhe procedura Vizita në institucion, në Zyrën e burimeve Njerëzore</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli përgjegjës për praktikën profesionale, është personel i departamentit të Menaxhimit, i cili është përgjegjës dhe garanton një proces të praktikave, të mbështetur nga marrëveshjet me organizata të biznesit, OJF, institucione shtetërore etj, sic edhe tregohet në nenin 28 të rregullores së KUQ. Procesi ndiqet nga pedagogët e përcaktuar dhe procedurat janë të mirëpërcaktuara në rregulloren e KUQ. Realizohet një komunikim i vazhdueshëm midis pedagogut përgjegjës, studentit dhe mbikëqyrësit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me e-mail në rastet kur vendi i praktikës ndodhet jashtë qytetit të Tiranës. Studentët pas periudhës së ndjekjes së praktikës, sjellin në institucion vërtetimin nga kompania/organizata dhe gjatë periudhës bëhen 4 takime me pedagogun udhëheqës të praktikës.</p> <p>KUQ ka një listë isitucionesh dhe kompanish me të cilat ka marrëveshje, duke garantuar realizimin e praktikës mësimore në mjediset e kompanive/organizatave përkatëse. Madje KUQ ka edhe mjedise të brendshme laboratorë dhe mjedise të tjera për zhvillim të aktiviteteve praktike. Për praktikën tek subjektet realizohet një marrëveshje e qartë me institucionet që i garanton studentit vendosjen në mjediset e kompanive/organizatave përgjatë gjithë periudhës së praktikës. Departamenti mban marrëdhënie edhe me zyrën Alumni dhe karrierës për identifikimin e kompanive që mund të jenë pjesë e listës për praktika mësimore. Është me rëndësi të theksohet se departamenti për përcaktimin e vendit të praktikës, merr parasysh dhe dëshirën e studentit dhe vendi vendoset në bashkëpunim, kjo e shprehur edhe në rregulloret përkatëse të institucionit dhe departamentit.</p> <p>Në përfundim të studimeve realizohet punimi i diplomës, ku vendoset në dispozicion personeli akademik udhëheqës i diplomës, zakonisht brenda departamentit ose dhe nga jashtë departamentit nëse vlerësohet e nevojshme, sigurisht me titujt dhe kualifikimet përkatëse. Gjithashtu për studentët që nuk përmbushin kriterin e mesatares, mbrojtja e diplomës bëhet me provim.</p>




	<p><i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i> <i>EV.3_4_Rregullore departamenti</i> <i>Ev. 1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit</i> <i>Vizita në institucion, takimi me studentët,</i></p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, bën mbikqyrjen e studentit gjatë periudhës së praktikës së bashku me pedagogun e përcaktuar për udhëheqje dhe mbikqyrje. Gjithashtu mbikqyrësi në institucionin pritës merr pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. Kështu në përfundim të praktikës mësimore personeli mbikqyrës vlerëson punën e kryer nga studenti sipas një formati standart dhe e dorëzon atë pranë departamentit.</p> <p><i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i> <i>EV.3_4_Rregullore departamenti</i> <i>Vizita në institucion, takimi me pedagogët dhe studentët e programit tëstudimit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit realizohet nga një departament me përvojë brenda fakultetit të Ekonomisë, si dhe ka pedaogë me titujt, gradat dhe eksperiencën e duhur për të mbështetur të gjitha procedurat e studentëve deri në diplomim si mbrojtjet e praktikave dhe diplomave. Rregulloret përkatëse janë të qarta dhe gjenden nga vizita në institucion, të mirëzbatuara lidhur me të gjitha pikat më sipër.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të</p>	<p>Mjediset e KUQ janë në dispozicion të të gjithë studentëve dhe pedagogëve e si rrjedhim edhe të studentëve të programit të studimit. Ambjentet fizike përfshijnë salla leksionesh seminaresh dhe laboratorë për zhvillimin e lëndëve aplikative. Godina ka në dispozicion një numër prej 3 salla leksionesh, 7 salla seminaresh si edhe zyra, laboratorë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>informatike dhe biblioteka si dhe mjedise të përbashkëta. Ky program studimi ka dhe laboratorin me hapësira të mjaftueshme të dedikuara për studentët e këtij programi. Hapësirat infrastrukturore janë të rëndësishme dhe KUQ është angazhuar në krijimin e një mjedisi mbështetës në të gjithë veprimtarinë e mësimdhënies.</p> <p><i>Ev. 1_24_Infrastruktura mësimore KUQ</i> <i>Ev. 1_24_Infrastruktura mësimore pjesa II</i> <i>Vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Çdo sallë leksioni apo edhe seminari është pajisur me videoprojektor dhe gjithashtu me kompjuter desktop ose laptop. Në cdo sallë si edhe në mjedise të përbashkëta, vihet re suporti i teknologjisë, gjë që është edhe në prioritetet e institucionit, për tu realizuar në vijimësi dhe pak nga pak. Laboratorët janë të pajisur me një numër të konsiderueshëm kompjuterash duke patur parasysh grupet e studentëve.</p> <p><i>Vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sipas vizitave në institucion dhe në strukturat e Fakultetit të Ekonomisë, u pa se laboratorët janë të përshtatur për realizimin e orëve të lëndëve bazë dhe lëndëve të lidhura drejtpërdrejt me diplomën e nivelit bachelor, sidomos në këtë program studimi ka laborator të dedikuar lëndëve dhe aftësive praktike.</p> <p><i>Ev. 1_24_Infrastruktura mësimore KUQ</i> <i>Ev. 1_24_Infrastruktura mësimore pjesa II</i> <i>Vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me</p>	<p>Në KUQ, por në funksion edhe të këtij programi studimi është në dispozicion një laborator i dedikuar, me Pajisjet e mjediseve të një posti recepsioni, të një shtate akomodimi, të një mjedisi restoranti, ku studentët mund të bëjnë praktika, të dedikuara. Sigurisht janë sallat të pajisura me kompjuter,</p>




programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	videoprojektor dhe ku studentët mund të realizojnë orët e seminareve, si edhe labororet e lëndëve të dedikuara. Duke parë edhe mundësitë e punësimit në sektorët e turizmit, sipas studimit të tregut dhe vizitës në institucion, këto janë mjedise laboratorike shumë të rëndësishme për aftësimin e studentëve. <i>Vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve</i>			
Konkluzione	<i>Mjediset mësimore dhe infrastruktura janë shumë të përshtatshme dhe të kompletuara për realizimin me sukses të programit të studimit dhe gjithashtu për të rritur kapacitetet e studentëve të lidhura me tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Biblioteka përmban literaturën e nevojshme të lidhur me programin e studimit. Gjithë literaturat në formën e librave dhe revistave në gjuhën shqipe dhe të huaj janë të kategorizuara sipas standarteve të bibliotekave, Ka një numër të konsiderueshëm titujsh në bibliotekën e KUQ, ku ka po ashtu tituj të revistave, proceedings te konferencave kombëtare e ndërkombëtare, revista etj.</p> <p><i>Por patjetër që kërkohet një përditim me literaturat më të fundit, sidomos në shqip dhe departamenti i Menaxhimit të Biznesit bën përpjekje të vazhdueshme për këtë. Biblioteka garanton gjithashtu aksesin në disa databaza digjitale, ku në aspektin ekonomik mund të përmendim EconBiz, Open text book library, Open dissertations, Springerlink etj. Duke qene se ka bibliotekë dixhitale në dispozicion, kjo siguron më shumë cilësi në literaturën për programin e studimit.</i></p> <p>Gjithashtu biblioteka ka edhe katalogimin online në sistemin e bibliotekave, gjë që siguron përdoruesit të kenë informacion për gjithë titujt që janë në dispozicion si edhe të kërkojë tituj për të cilët ka interes.</p>




	<p><i>Ev. 1_26_Vendim i B A për pagesën e konferencave dhe bibliotekës</i></p> <p><i>Evidenca shtesë: kërkesa per pasurimin e bibliotekes me tituj</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësim të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Ndërsa njësia përgjegjëse dhe stafi akademik i programit bën kërkesat zyrtare mbi përditimin e titujve dhe literaturave të nevojshme për programin e studimit, nepermjet departamentit dhe raportimeve vjetore jepet dhe informacion per rastet kur eshte perditesuar literatura.</p> <p><i>Ev. 1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës</i></p> <p><i>Evidenca shtesë: kërkesa per pasurimin e bibliotekes me tituj</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Burimet e bibliotekës janë kryesisht burime si për stafet akademike, edhe për studentët të cilët informohen dhe nxiten më shumë në përdorimin e këtyre burimeve, nëpërmjet komunikimit me pedagogët e secilës lëndë si edhe komunikimeve në mjediset e bibliotekës apo në mediat online të KUQ. Mundësia e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë tregohet edhe në të dhënat për infrastrukturën e bibliotekës dhe rregulloren e brendshme të saj, ku shpërndarja e titujve dhe organizimi i mjediseve bëhet që të gjithë përdoruesve të bibliotekës tu jepen mundësi të barabarta.</p> <p><i>Ev. 1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës</i></p> <p><i>Vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve të bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e KUQ ka në fondin tituj ku përfshihen tekstat mësimore si dhe literature ndihmëse si dhe janë të kategorizuara në tituj shqip dhe të huaj. Gjithashtu ka tituj nga periodikë fizikë dhe të shkarkuar nga periodikët online. Mbulohen afërsisht të gjitha modulet mësimore të programit të studimit. <i>Megjithatë ka ende hapësirë për përditësimin e titujve sidomos në Shqip.</i> Diskutimi me pedagogët e programit të studimit vuri në pah problemet e botimit të librave në shqip, në përgjithësi jo vetëm për këtë program studimi. Por të gjithë pedagogët janë mbështetur me cikle leksionesh të miratuara.</p> <p><i>Ev. 1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës</i></p> <p><i>Evidenca shtesë: kërkesa per pasurimin e bibliotekes me tituj</i></p> <p><i>Vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve të bibliotekës</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas informacionit mbi bibliotekën dhe rregulloreve të programit të studimit studentët mund të shfrytëzojnë bibliotekën në mënyrë të barabartë dhe pa pagesë. Studentët mund të shfrytëzojnë mjediset dhe të aksesojnë materialet për projektet, detyrat apo lexim gjatë orareve të studimit dhe leximit.</p> <p><i>Ev. 1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës</i> <i>Vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve të bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka e KUQ menaxhon fondin përmes programit elektronik të instaluar për këtë qëllim në kompjuterin e bibliotekës, për menaxhimin e katalogut të bibliotekës sipas kategorive të ndryshme duke kontrolluar lehtësisht lëshimin/kthimin/vonesat/humbjet apo dëmtimet. Secili përdorues duhet të bazohet në rregulloren e bibliotekës për të aksesuar burimet dhe bazuar mbi menaxhimin e duhur materialet shfrytëzohen pa kufizim për të gjithë, jo vetëm pedagogët, por edhe për studentët.</p> <p><i>Ev. 1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës</i> <i>Vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve të bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Stafi i bibliotekës menaxhon procesin e aksesit dhe menaxhimin të procesit të leximit dhe marrjes së librave, apo materialeve të tjera. Oraret e bibliotekës janë të përshtatshme për përdorimin dhe frekuentimin nga studentët, pasi është mundur që oraret e saj të përputhen me mundësitë për oraret e studentëve.</p> <p><i>Ev. 1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës</i> <i>Vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve të bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga</p>	<p>Raportimi për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe për përditësimin realizohen nga stafi i bibliotekës. Pedagogët e stafit të programit në analizën në departamente japin informacion lidhur edhe me gjendjen e literaturave si dhe përditësimin e leksioneve dhe materialeve të cilat u shërbejnë studentëve por edhe fondit të bibliotekës.</p> <p><i>Ev. 1_9_Rregullore e brendshme e bibliotekës</i> <i>Vizita në institucion, vëzhgimi i mjediseve të bibliotekës</i></p>




personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.									
Konkluzione	<i>Institucioni përmbush thujse tërësisht kushtet për literaturën dhe shërbimet e bibliotekës duke garantuar paanshmëri, mundësi të barabara, orare shërbimesh të përshtatshme si edhe zhvillim dhe kualifikim të stafit.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Institucioni nuk disponon aktualisht një sistem të menaxhimit të informacionit ku të administrohen të gjitha informacionet e lidhura me studentët, që nga regjistrimi e deri në diplomim. Pjesë të shkëputura të informacionit dhe komunikimit realizohen me studentët në format tradicionale, apo në format fillestare të komunikimit me e-mail apo mjete të tjera sociale të komunikimit.</p> <p><i>Ev. 1_18_ Metodat e mësimdhënies në distancë</i></p> <p><i>Ev. 1_19_ Udhëzues për përdorimin e platformave on-line</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me anëtarët e stafit, takimi me sekretarinë mësimore.</i></p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe	Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik dhe ndihmës akademik dhe administrative, në mënyrë tradicionale dhe jo në formë elektronike.




<p>aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p><i>Ev. 1_18_ Metodatat e mësimdhënies në distancë</i> <i>Ev. 1_19_ Udhëzues për përdorimin e platformave on-line</i> <i>Vizita në institucion, takimi me anëtarët e stafit, takimi me sekretarinë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Po bëhen përpjekjet për ndërtimin e sistemit të brendshëm elektronik për shkëmbimin e të dhënave, por këto janë ende në hapat fillestare, kështu që edhe akses i dedikuar në informacione dhe dokumenta është në nivel të ulët, gjithnjë krahasuar me standartet e një sistemi të brendshëm elektronik.</p> <p><i>Ev. 1_18_ Metodatat e mësimdhënies në distancë</i> <i>Ev. 1_19_ Udhëzues për përdorimin e platformave on-line</i> <i>Vizita në institucion, takimi me anëtarët e stafit, takimi me sekretarinë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Format e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve, janë format publike në platforma të përdorshme nga të gjithë dhe që patën akses gjatë periudhës së pandemisë, si google meet. Për shkëmbimin e informacionit aktualisht përdoret posta elektronike, por jo një sistem i mirëfilltë me akses në cdo kohë dhe akses të dedikuar.</p> <p><i>Ev. 1_18_ Metodatat e mësimdhënies në distancë</i> <i>Ev. 1_19_ Udhëzues për përdorimin e platformave on-line</i> <i>Vizita në institucion, takimi me anëtarët e stafit, takimi me sekretarinë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Nuk mund të flitet për monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrative në KUQ, për sa kohë nuk ekziston sistem i brendshëm informacioni, por format tradicionale të kontrollit dhe monitorimit zbatohen me rigorozitet dhe mundësojnë pasjen nën kontroll të realizimit të aktivitetit mësimor, kërkimor-shkencor.</p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me anëtarët e stafit, takimi me sekretarinë mësimore.</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e</p>	<p>Faqja e Internetit e KUQ është e përditsuar dhe ka gjithë informacionet që i duhen studentit për programin e studimit,</p>




studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	zyrat mbështetëse dhe çdo informacion tjetër me rëndësi. Por web-site i KUQ nuk është i publikuar në gjuhën angleze, vetëm në Shqip. https://qiriaz.edu.al								
Konkluzione	<i>Sistemi i brendshëm i informacionit është bërë një domosdoshmëri dhe aktualisht nuk është në nivele të kënaqshme në këtë kolegji. Ka disa forma të komunikimit elektronik, të përdorshme edhe për komunikimin nëpërmjet mediave digjitale, të cilat lejojnë një nivel përmbushjeje, por jo të plotë dhe jo në nivele të larta të këtij standarti.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi IV.5


Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Ligji i arsimit të lartë 80/2015 krijon gjithë hapësirat ligjore për ndërtimin e mekanizmave të duhur për menaxhimin financiar të institucioneve të arsimit të lartë publikë dhe privatë në vend. Në statutin e KUQ thuhet se institucioni është jopublik me vetëfinancim dhe drejtuesi më i lartë përgjegjës për administrimin edhe financiar të institucionit është Administratori. Bordi i Administrimit është gjithashtu organi më i lartë për administrimin financiar, i cili është përgjegjës për alokuimin e duhur të fondeve. Në bashkëveprim me menaxhimin e institucionit, si edhe në zbatim të gjithë udhëzimet përkatëse, është e mundur të kalohet deri në nivelin e programeve të studimit. Në relacionin për realizimin e buxhetit dhe planifikimin, mund të evidentohen elementët e realizimit financiar të buxhetit. Parashikimet për vitete e ardhshme bëhen në projekt buxhetin afatmesëm. KUQ ka një raport financiar të qartë dhe të plotë mbi të ardhurat dhe kostot, duke u bazuar në ndarjen e tyre në disa zëra të ardhurash dhe shpenzimesh, në nivle institucional. Nuk ka një ndarje reale të mjeteve financiare dhe parashikimit në nivel programi studimi.

	<p><i>Ev. 1_1 Statuti KUQ</i></p> <p><i>Ev. 1_22 Plani buxhetor</i></p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Planifikimi financiar fillon që nga njësia bazë me kërkesat e paraqitura nga përgjegjësi i departamentit në dekanat dhe më pas në senatin akademik dhe bordin e administrimit. Dokumentacioni tregon për realizimin e një plani financimi në nivel institucional dhe jo në nivel programi studimi ku të evidentohen të gjitha kostot, psh kostot e personelit akademik, vetëm të këtij programi studimi.</p> <p>Në mbyllje të cdo cikli të plotë studimi institucioni dokumenton raportet financiare për tre vitet e fundit dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme.</p> <p><i>Ev. 1_1 Statuti KUQ</i></p> <p><i>Ev. 1_4_2 Rregullore e BA</i></p> <p><i>Ev. 1_4 Rregullore e Kolegjit</i></p> <p><i>Ev. 1_22 Plani buxhetor</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni përparat raportet vjetore financiare dhe gjithë procedurat për miratim të vendimeve që lidhen me buxhetin dhe financat përcaktohen në statut dhe rregullore, të cilat zbatohen me rigorozitet. Sa i përket auditimit periodik, nuk ka një procedurë që evidenton për këtë auditim si pjesë e auditit të brendshëm apo edhe të jashtëm.</p> <p><i>Ev. 1_1 Statuti KUQ</i></p> <p><i>Ev. 1_4_2 Rregullore e BA</i></p> <p><i>Ev. 1_4 Rregullore e Kolegjit</i></p> <p><i>Ev. 1_22 Plani buxhetor</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi</p>	<p>Raportimet janë në nivel institucional dhe ato të lidhura me realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve shkojnë në nivel fakulteti dhe mund të nxirren deri në nivel programi studimi.</p> <p><i>Ev. 1_22 Plani buxhetor</i></p>

realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.									
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	<p>Qëndrueshmëria financiare e institucionit garantohej për shkak të të ardhura nga burime të ndryshme të diversifikuara, ku KUQ ka mundur të mbledhë fonde nga tarifat e studentëve, ofrimi i shërbimeve mbështetëse. Gjithashtu në rritje kanë qenë edhe të ardhurat nga studentët për shkak të rritjes së numrit të programeve të studimit dhe numrit të studentëve në disa prej tyre.</p> <p><i>Ev. 1_22_Plani buxhetor</i></p>								
Konkluzione	<i>Realizohet buxheti, evedentimi i kostove dhe analizave financiare dhe auditimit gjë që kërkohet nga ky kriter. Në nivel institucional apo dhe fakulteti këto analiza dhe planifikime janë realizuar.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						




V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje paraqiten në statutin dhe rregulloret përkatëse të institucionit, Fakultetit dhe Departamentit. Bazuar në legjislacionin në fuqi institucioni vë në dispozicion të gjitha strukturat mbështetëse për të garantuar mbulimin e të gjitha aktiviteteve të studentëve nga hyrja në dalje. Struktura për shërbimet studentore përfshin janë kryesisht sekretaria mësimore, personeli ndihmës akademik në nivelet e ndryshme si dhe zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Pranimeve dhe këshillimit për karrierë. Të gjitha proceset gjatë programit të studimit, në diplomim dhe pas diplomimit mbështeten nga këto zyra në KUQ sipas rregullores së përgjithshme (Kreu, VIII, organizimi i studimeve dhe nenet 100,101,104 për zyrat mbështetëse) dhe statutit (kreu V studentët).</p> <p><i>Ev. 1 1 Statuti KUQ</i> <i>Ev. 1 4 Rregullore e Kolegjit</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas Statutit dhe Rregullores KUQ, studimet në programin e studimit Bachelor në Menaxhim Hoteleri - Turizëm, ashtu si në të gjitha degët mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarë etnikë dhe të huaj sipas kriterëve të përcaktuara. Strukturat e njësisë bazë, Zyrave mbështetëse të përmendura në kriterin 1, japin shërbimet dhe mbështetjen e tyre pa asnjë dallim dhe diskriminim për të gjithë studentët duke i trajtuar ata në kushte të barabarta.</p> <p><i>Ev. 1 1 Statuti KUQ</i> <i>Ev. 1 4 Rregullore e Kolegjit</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në</p>	<p>Pranimi në këtë program studimi bëhet sipas kërkesave ligjore në fuqi për çdo student që ka përfunduar maturën shtetërore. Në këtë program studimi nuk ka disa kritere të vecanta për vetë natyrën e programit. Sipas vendimeve për kriteret, përvec rregullores se KUQ për pranimin e studentëve dhe funksionet</p>

<p>programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>e zyrës së pranimit dhe regjistrimit, zbatohen edhe vendimet e organeve të tjera drejtuese, sipas rastit.</p> <p><i>Ev._1_1_Statuti KUQ</i></p> <p><i>Ev._1_4_Rregullore e Kolegjit</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve janë transparente në Web-sitin e Kolegjit, ku thuhet se kriteri i pranimit për aplikim në të gjitha programet e ciklit të parë Bachelor në KUQ është “kriteri i meritës së maturës shtetërore dhe nota mesatare e studimeve” të arsimit të lartë të mesëm, përcaktuar sipas vendimit të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu në rregulloret dhe statutin e KUQ, të cilat janë publikuar në ëeb-site janë transparente kriteret, procedurat dhe dokumentacioni i duhur për transferim dhe regjistrim në degët e dyta. Gjithashtu ka informacion të bollshëm për studentët të aksesueshëm nga publiku sa u përket sidomos studentëve, dhënies dhe vlerësimit të dijeve dhe diplomimit.</p> <p>https://qiriaz.edu.al/legjislacioni-2/</p> <p>https://qiriaz.edu.al/bachelor-menaxhim-hoteleri-turizem/</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Informacioni për aplikantët maturantë, lidhur me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të programit Menaxhim në Hoteleri-Turizëm përgatitet nga njësia bazë dhe miratohet nga senati akademik. Programet e studimit, kuotat së bashku me kriteret e pranimit publikohen dhe janë lehtësisht të aksesueshme në portalin U – Albania, ku institucioni përditëson vazhdimisht kriteret në seksionin përkatës. Në Web-site të KUQ gjithashtu ka një formular që plotësohet nga ai që kërkon të aplikojë duke lehtësuar procesin dhe më pas ka një komunikim të vazhdueshëm me aplikantin.</p> <p><i>Megjithate numri i studenteve per kete program studimi mbetet i ulet, por duke u perpjekur qe te rritet ne te ardhmen.</i></p> <p>https://qiriaz.edu.al/legjislacioni-2/</p> <p>https://qiriaz.edu.al/apliko-tani/</p>



<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Si për gjithë programet, edhe për këtë program botohen kuotat për studentët, por, si në rregulloret apo edhe në vendimin e senatit, <i>nuk ka kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, pakicave, apo shtresave të marginalizuara, por ato nuk diskriminohen dhe ka kuota sipas ligjit.</i></p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti KUQ</i> <i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i></p>		
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në rastet e kuotave për student të huaj, KUQ lejon ndjekjen e studimeve edhe nga këta studentë si dhe nga studentët nga trojet shqiptare, sipas të gjitha udhëzimeve të MAS. Institucioni nuk vendos kritere të veçanta, përveç atyre të vendosura nga MAS, të cilat ndiqen rigorozisht, për ndjekjen e studimeve nga studentë të kësaj kategorie.</p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti KUQ</i></p>		
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Vendimet për mbështetjen e studentëve me bursë janë një nxitje që KUQ mund të bëjë për kategori studentësh të caktuar, bazuar në kriteret dhe aktet e brendshme normative. KUQ ka përcaktuar kriteret për të cilat institucioni mund të miratohë bursat dhe këto janë bërë publike në Web-sitin zyrtar.</p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti KUQ</i> https://qiriaz.edu.al/bursat-e-studimit/</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni përmbush gjithë kornizën ligjore në fuqi, si dhe ka ndërtuar rregullore dhe procedura për të zbatuar këtë kornizë, lidhur me pranimin e studentëve, mbështetjen e tyre në procesin e shkollimit, mundësitë që u jep lidhur me mbështetjen financiare etj.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në statutin e KUQ, në rregulloren e institucionit, si dhe në rregulloren e programit të studimit, paraqiten të gjitha procedurat se si studentët përparojnë gjatë programit, në lidhje me kurset, kreditet, kalimin nga një vit në tjetrin, diplomimin.</p> <p>Kohëzgjatja e studimeve, kushtet e kalimit në vitin pasardhës dhe ecuria e studimeve janë elemente të parashikuara në rregulloret e departamentit dhe rregulloren e studimeve bachelor në Menaxhim Hoteleri-Turizëm. Rregulloret kryesore janë të botuara në web-site, por vec kësaj studentët bëhen me dije në fillim të çdo viti akademik. Procedurat e përparimit akademik lidhen me procesin e mësimdhënies. Një pjesë e këtij informacioni është transparent në Web-site, si edhe përgjatë semestrave dhe vitit akademik. Çdo pedagog vendos në dispozicion syllabusin, me informacion mbi kreditet, synimet, temat, mënyrën e vlerësimit dhe këto shërbejnë për informimin e studentit se si do të mund të përparojë gjatë studimeve në çdo modul.</p> <p><i>EV.3_4_Rregullore departamenti</i> <i>Vizita në institucion, takimi me pedagogët e programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Rregulloret gjithashtu përmbajnë nenet përkatëse për të informuar studentët në rastet e transferimeve për procedurat e njohjes së provimeve të mëparshme bazuar mbi programet si edhe njohjen e lëndëve dhe provimeve nga komisionet ad-hoc të ngritura për këtë qëllim.</p> <p><i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit kreu X</i> <i>EV.3_4_Rregullore departamenti kreu VIII</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Takimet informuese me studentët e kursit të parë nga përgjegjësi i departamentit dhe stafi akademik përbëjnë edhe një element shtesë për informimin mbi modulet, procedurat dhe mënyrat e përparimit të studentëve përgjatë gjithë periudhës së studimeve. Zyra e pranimit, sekretaritetë mësimore dhe stafet mbështetëse të departamenteve janë në dispozicion të studentëve të interesuar për të marrë më tepër informacion për çdo çështje me interes përgjatë periudhës së studimeve.</p> <p><i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i></p>



	<i>EV.3_4_Rregullore departamenti</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit të studentëve janë të mire përcaktuara në rregulloret përkatëse. Studentët informohen nëpërmjet takimeve informuese në cdo fillim viti akademik, si dhe nëpërmjet komunikimit në kohën kur studentët do të fillojnë procesin e diplomimit, pas përfundimit të semestrit përkatës. Kreu VII i rregullores së departamentit përmban procedurat e diplomimit, si me temë diplome ashtu edhe me provim formimi. Gjithashtu nenet përkatëse (48, 50) kanë orientime mbi transparencën dhe komunikimit me studentët. <i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i> <i>EV.3_4_Rregullore departamenti</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Fushata të informimit të studentëve si edhe faqja e Internetit janë dy mjete kryesore për udhëzimin dhe informimin e të interesuarve për të studiuar pranë KUQ si dhe në programin e studimit bachelor në Menaxhim Hoteleri-turizëm. Janë realizuar takime të hapura nëpër shkollat e mesme për informimin e të interesuarve si dhe janë realizuar broshura për këtë qëllim. <i>Ev. 1_37_Fletëpalosje e Kolegjit</i> <i>Ev. 1_35_Marketingu në Kolegjin Universitar Qiriazi</i> <i>Vizita në institucion takimi me studentët</i>			
Konkluzione	<i>Informimi i studentëve mbi rrugën e tyre të përparimit akademik realizohet nga institucioni dhe mjetet e informimit sidomos Website por edhe mjetet e komunikimit fizik të drejtpërdrejtë, po përdoren në mënyrën e duhur.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve





<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Struktura, organizimi dhe kohëzgjatja e programit të studimit është e parashikuar në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programin e studimit bachelor në Menaxhim Hoteleri-Turizëm. Përveç informimit përmes publikimeve në faqen e Internetit të institucionit, informacion jepet nëpërmjet takimeve në fillim të vitit akademik, takimeve me maturantët në ditët e informimit si dhe takimeve dhe komunikimeve me kooridnatorin e programit, gjatë viteve të studimit dhe kur studentët e kërkojnë apo e kanë të nevojshme.</p> <p><i>EV.3_4_ Rregullore departamenti</i> <i>EV.3_6_ Rregullore e programit te studimit</i> <i>Vizita në institucion takimi me studentët</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit jep informacionin e nevojshëm për lëndët, modulet e programit të studimit. Mënyra se si institucioni informon studentët mbi programet e studimit dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese është përmes, botimit të kurrikulës së detajuar me informacion në faqen e programit në web-site, prezantimit me informacionin që në fillim të regjistrimit të studentëve në KUQ dhe në takimet e para informuese, si dhe nëpërmjet prezantimit të syllabuseve të cdo lënde në fillim të cdo semestri, sipas rregulloreve përkatëse të departamentit dhe programit të studimit.</p> <p><i>EV.3_4_ Rregullore departamenti</i> <i>EV.3_6_ Rregullore e programit te studimit</i> https://qiriaz.edu.al/bachelor-menaxhim-hoteleri-turizem/</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Elementi primar që i shërben institucionit dhe specifikisht departamentit për të promovuar studentët në tregun e punës është praktika profesionale. KUQ ka një sërë marrëveshesh me kompani/organizata/administrate, ku në këtë diplomë mbështen studentët në procesin e praktikës duke sygjeruar dhe garantuar marrëveshje fillestare në tregun e punës. Nëpërmjet koordinimit me zyrën e këshillimit të karrierës dhe alumni, Institucioni mundëson mbështetje për orientim në tregun e punës, si dhe në disa aspekte të këshillimit për ndërtimin e CV, aplikimit për punë, letres së motivimit, kërkimit të informacionit për punë, etj. Institucioni ka realizuar dhe promovuar panairë karriere gjithashtu dhe në</p>

	<p>qytete të ndryshme dhe i publikon këto informacione në web-site.</p> <p><i>Ev. 1_34_ Marrëveshjet e bashkëpunimit</i></p> <p><i>Ev. 1_14_Rregullore e ZMJP&KK</i></p> <p><i>https://qiriaz.edu.al/neës-te-gjitha/</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Informacioni i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, gjendet në web-site si dhe komunikohet fizikisht nga bashkëveprimi midis studentëve dhe koordinatorit të departamentit dhe sekretarisë mësimore. Informacioni mbi orarin dhe sallat është i afishuar dhe orientimet fizike janë të mirë organizuara.</p> <p><i>EV.3_4_Rregullore departamenti</i></p> <p><i>EV.3_6_Rregullore e programit te studimit</i></p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit është tradicional dhe jo elektronik, por vlerësimet jepen në mënyra elektronike si nëpërmjet e-mailit. Numri i studentëve lejon menaxhimin tradicional, por KUQ po punon për ndërtimin dhe zbatimin e sistemi elektronik në të ardhmen. Ndërkohe informacioni ndodhet edhe në faqen e Internetit, mbi lëndët dhe modulet duke qenë lehtësisht arritshëm për studentët. Mjete dhe platforma digjitale janë përdorur për mësimdhënien dhe shpërndarjen e materialeve më shumë gjatë pandemisë, por edhe në vijimësi. Institucioni ka manual përkatës për përdorimin e platformave elektronike.</p> <p><i>Ev. 1_18_Metodat e mësimdhënies në distancë</i></p> <p><i>Ev. 1_19_Udhëzues për përdorimin e platformave on-line</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me pedagogët e programit dhe me studentët</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni realizon informacion të plotë studentëve për programin, modulet, procesin e edukimit dhe diplomimin. Këto informacione gjenden në rregulloret e programit të studimit, rregulloren e departamentit dhe institucionit, si dhe nepermjet dokumentacioneve të ndryshme që janë edhe transparente për studentet nëpërmjet metodave të ndryshme të komunikimit dhe transferimit të informacionit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




				X
--	--	--	--	---

Standardi V.4							
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.							
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>KUQ përmes Sekretarisë Mësimore dhe zyrës së Alumni dhe Karrierës, grumbullon dhe përpunon të dhënat lidhur me regjistrimet/aplikimet duke përpunuar të dhënat lidhur me numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar, si dhe gjurmimin e studentëve, për programin e studimit bachelor në Menaxhim Hoteleri-Turizëm. Roli i sekretarisë mësimore jepet në rregulloren e institucionit, departamentit dhe programit të studimit, lidhur me mbajtjen dhe përdorimin e të dhënave të studentëve. Gjithashtu edhe vetë rregullorja e sekretarisë mësimore shprehet qartë për këtë rol.</p> <p>Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet e fundit akademike ishte:</p> <table> <tr> <td>Viti 2021-2022</td> <td>10 studentë;</td> </tr> <tr> <td>Viti 2022-2023</td> <td>8 studentë;</td> </tr> <tr> <td>Viti 2023-2024</td> <td>5 studentë;</td> </tr> </table> <p><i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i> <i>EV.3_4_Rregullore departamenti</i> <i>Ev. 1_12_Rregullore e sekretarisë mësimore</i></p>	Viti 2021-2022	10 studentë;	Viti 2022-2023	8 studentë;	Viti 2023-2024	5 studentë;
Viti 2021-2022	10 studentë;						
Viti 2022-2023	8 studentë;						
Viti 2023-2024	5 studentë;						
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni përmes zyrës së Sekretarisë Mësimore gjithashtu mban informacion për të gjithë studentët që janë larguar nga programi përpara përfundimit apo për mospërfundimin me sukses të programit. Evidentimi për këtë fakt u bë në vetë zyrën e sekretarisë, por duke aksesuar regjistrat e ndërtuara nga vetë institucioni pasi ata nuk janë pajisur me regjistra nga MAS. Gjithsesi, u mor një kampionim për programin e studimit dhe u panë standartet e ruajtjes së informacionit.</p> <p><i>Evidenca shitesë: shkresa per QSHA dhe kërkesa per pajisje me regjistra</i></p>						




	<i>Vizita në institucion në Sekretarinë Mësimore, kontrolli I të dhënave të ruajtura.</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	<p>Të dhënat statistikore menaxhohen përmes sistemit tradicional të shpjeguar më lart dhe sekretarisë mësimore që ka rolin themelor, duke ruajtur të dhëna mbi notat, duke u ruajtur më pas dhe në regjistra së bashku me vlerësimet dhe arritjet akademike. Nuk ka nje sistem informacioni te kompjuterizuar.</p> <p><i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i> <i>EV.3_4_Rregullore departamenti</i> <i>Ev. 1_12_Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>Ev. 1_10_Rregullore e mbrojtjes së të dhënave personale</i></p>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	<p>Zyra e Sekretarisë Mësimore është gjithashtu përgjegjëse për menaxhimin e dokumentacionit në mënyrë që të ketë mundësi të vlerësojë gjendjen aktuale dhe saktësinë e informacionit të studentëve dhe vlerësimeve të tyre të arritjeve akademike. Çdo student ka dosjen e tij me të dhënat që nga fillimi i marrëdhënies me institucionin, regjistrimit dhe në vijimësi arritjet akademike për cdo vit, e deri në përfundim.</p> <p><i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i> <i>EV.3_4_Rregullore departamenti</i> <i>Ev. 1_12_Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>Vizita në institucion në Sekretarinë Mësimore, kontrolli I të dhënave të ruajtura</i></p>
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Departamenti i Menaxhimit harton raporte analitike të përvitshme të punës së departamentit, dhe gjithashtu KUQ harton raportin vjetor, duke përfshirë të dhënat e nevojshme për analizat vjetore lidhur me studentët, notat mesatare, probleme të cilësisë, etj.</p> <p>Duhet te kete me shume analiza mbi shkallen e cilesise se punesimit si dhe raportime analitike mbi te dhenat e studenteve.</p> <p><i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i> <i>EV.3_4_Rregullore departamenti</i> <i>EV.3_5_ANALIZA VJETORE E DEPARTAMENTIT</i></p>




Konkluzione	<i>Të dhënat dhe statistikat vjetore të studentëve ruhen në mënyrën e duhur, por përpunimet janë minimale dhe mund të përpunohen më thellësisht nga Departamenti.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>Studentët janë pjesë e strukturave drejtuese sipas ligjit 80/2015. Në KUQ studentët përfaqësohen edhe në përbërje të Senatit Akademik, Këshillin e Etikës, NJSBC dhe komisionet e përhershme. Studentët organizohen gjithashtu në këshillin studentor/qeverinë studentore. Këshillat e studentëve janë organizata të pavarura të cilat nuk ushtrojnë veprimtari ekonomike apo politike, por sigurojnë pjesëmarrjen e studentëve në procesin zgjedhor dhe koordinojnë pjesëmarrjen me përfaqësim në organet drejtuese, sipas ligjit për arsimin e lartë 80/2015.</p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti KUQ</i> <i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i> <i>Ev. 1_4_1_Rregullore e Senatit</i> <i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_4_3_Rregullore e Këshillit Studentor</i></p>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të	<p>E drejta e studentëve për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur në mënyrë që të përfaqësohen në organet drejtuese dhe komisionet e përhershme garantohehet nga statuti i KUQ. Nga ana tjetër studentët marrin pjesë në procesin e vlerësimit të punës së programit dhe pedagogëve përkatës, kjo përmes anketimeve të studentëve, të organizuara nga NJSBC. Ky proces u jep atyre një fuqi reale për të ndikuar në proceset e mëtejshme për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti KUQ</i></p>




verifikueshme e të matshme.	<p><i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i></p> <p><i>Ev. 1_4_3 Rregullore e Këshillit Studentor</i></p> <p><i>Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë</i></p>		
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Në KUQ për secilin prej programeve të studimit, si rrjedhim dhe për programin bachelor në Menaxhim Hoteleri-Turizëm, zhvillohen dy herë në vit, përpara sezonit të provimeve pyetësorët me studentët të cilët janë burimi më i rëndësishëm zyrtar që i përfshin studentët në dhënien e informacionit lidhur me lëndët dhe pedagogët, lidhur me vlerësimin për programin dhe sygjërimet përkatëse. Në mënyrë informale gjithashtu një informacion mbi mendimet e studentëve si dhe sygjërme lidhur me kurrikulën jepet në klasë në seancat e pyetjeve dhe diskutimeve sidomos në disa lëndë specifike të përshtatshme.</p> <p><i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i></p> <p><i>Vizita në institucion me pedagogët e programit dhe studentët e programit</i></p>		
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Marrja parasysh e mendimeve të studentëve për hartimin, rishikimin dhe përmirësimin e programeve relaizohet si nëpërmjet plotësisht të anketave, ku një informacion i kërkuar është përmes pyetjes së lidhur me procesin mësimor dhe programet apo informacionin në lidhje me lëndën, ashtu edhe përmes komunikimit në klasë në diskutim me pedagogun e lëndës. Gjithashtu ata kanë mundësinë të japin mendimet e tyre nëpërmjet përfaqësisë në organet drejtuese sipas statutit dhe rregullores.</p> <p><i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i></p> <p><i>EV.3_4_Rregullore departamenti</i></p> <p><i>EV.3_6_Rregullore e programit te studimit</i></p>		
Konkluzione	<p><i>Institucioni përmbush kushtet dhe kriteret ligjore për përfshirjen e studentëve jo vetëm në organiet vendimmarrëse, por edhe nëpërmjet rregulloreve dhe procedurave të zbatuara, si dhe gjatë procesit të mësimdhënies, edhe në përmirësimin e këtij procesi.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Struktura drejtuese e KUQ e njësisë kryesore dhe e njësisë bazë Departamentit të Menaxhimit, janë në shërbim të vazhdueshëm të studentëve të kësaj dege. Dy fushat që bazohet shërbimi i studentëve janë: mësimdhënia dhe zhvillimi i karrierës.</p> <p>Ofrimi i shërbimeve dhe informacioneve është funksion dhe synim kryesor në KUQ nëpërmjet zyrave mbështetëse për studentët, ku aktualisht përfshihen syra e Sekretarisë Mësimore, Zyra e rekrutimit, pranimit dhe regjistrimit dhe Zyra e Alumni dhe Karrierës. Një shërbim që u orfon informacion të rëndësishëm studentëve por sidomos në pjesën e fundit të studimeve të tyre, në qasjen me tregun e punës, por edhe lidhur me praktikant dhe kompanitë në treg, është zyra e karrierës nëpërmjet shumë aktiviteteve që kanë në qendër lidhjen me tregun e punës. Rregulloret përcaktojnë edhe kanalet e komunikimit që përdoren për studentët, ku dhe eeb-site I institucionit ka rol kryesor.</p> <p><i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i> <i>EV.3_4_Rregullore departamenti</i> <i>EV.3_6_Rregullore e programit te studimit</i> <i>Ev. 1_12_Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>Ev. 1_14_Rregullore e ZMJP&KK</i></p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Sekretaria Mësimore dhe Zyra e rekrutimit, pranimit dhe regjistrimit ofron informacionin kryesor për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Sa i përket aspekteve të lidhura strikt me procesin mësimor, studentët mund t'i drejtohen koordinatorit të programit të studimit, por edhe departamentit për zgjidhjen e problemeve, ose Zyrës së Alumni dhe Karrierës për çështje të përparimit të mëtejshëm akademik dhe drejt tregut të punës.</p>

	<p><i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i> <i>EV.3_4_Rregullore departamenti</i> <i>Ev. 1_12_Rregullore e sekretarisë mësimore</i> <i>Ev. 1_14_Rregullore e ZMJP&KK</i> <i>EV.3_8_VENDIM EMERIM KOORDINATORI</i></p>		
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Alumni dhe Karrierës u shërben studentëve, për të mbështetur zhvillimin e karrierës së studentëve. Ajo në bashkëpunim me Departamentin e Menaxhimit ofron informacion mbi punësimin e mundshëm, praktikat, internship në bazë të programeve përkatëse. Përmes panairëve të punës, përmes një shumëllojshëmrie aktiviteteve dhe përmes shërbimit të saj, institucioni ka krijuar shumë mundësi për punësimin në tregun e përshtatshëm të punës, përmes promovimit dhe marrëveshjeve me kompani dhe organizatat, si dhe me ruajtjen e marrëdhënieve me alumni.</p> <p><i>Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NjSBC</i> <i>Ev. 1_34_Marrëveshjet e bashkëpunimit</i> <i>Evidenca shtesë, pas vizitës: Konkursi Future business nga zyra e karrieres</i></p>		
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Njësia bazë është ajo e Departamentit dhe në bashkëpunim me Zyrën e Alumni dhe Karrierës dhe Zyrën e pranimit dhe Regjistrimit, mbledh dhe përpunon të dhëna për studentët pas diplomimit. Zyra e Alumni dhe Karrierës është përgjegjëse për gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ajo përdor disa mjete për gjurmimin, si e-mail, telefon, media sociale duke mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me studentët. Gjithashtu ajo bën analiza vjetore lidhur me të dhënat e mbledhura dhe me gjurmimin dhe ua vë në dispozicion këto të dhëna organeve drejtuese.</p> <p><i>Ev. 1_14_Rregullore e ZMJP&KK</i> <i>Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NjSBC</i> <i>Vizita në Institucion me zyrën e Këshillimit të Karrierës</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Procedurat për orientimin e studentëve gjatë studimeve edhe pas përfundimit të tyre janë të mirëpërcaktuara nëpërmjet ngritjes së zyrave përkatëse si edhe të mirëzbatuara nga departamenti dhe për programin e studimit.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Duke u mbështetur në disa dokumente themelore sic janë Statuti i KUQ, Rregullorja e KUQ, si dhe disa rregullore të posaçme të lidhura me Procesin e cilësisë, si Rregullorja e NJSBC, mund të thuhet se metodat inovative janë të rëndësishme për zhvillimin e proceseve mësimdhënëse brenda institucionit. Edhe në planin strategjik të zhvillimit të Kolegjit dhe në dokumentat e programit të studimit, ka një sërë parimesh që vendosin mësimdhënie në një pozicion të favorshëm duke paraqitur nxitjen për përdorimin e metodave inovative. Udhëzuesi në nivel institucional për cilësinë dhe metodat inovative është pikërisht rregullorja e NJSBC dhe udhëzuesi për metodat e mësimdhënies, si dhe formularët përkatës që udhëheqin procesin e udhëzimit për përdorimin e metodave inovative. <i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_3_Plani strategjik i zhvillimit të Kolegjit</i> <i>Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit	Struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në KUQ sipas edhe rregulloreve përkatëse është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Ajo bashkërendon gjithashtu veprimet me Rektorin për çështjet akademike si dhe organet drejtuese për matjen e performancës dhe për të ushtruar sa më mirë veprimtarinë në KUQ si dhe për programin e studimit bachelor në Menaxhim Hoteleri-

<p>akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Turizëm. Mekanizmat e vendosur në rregulloret dhe udhëzuesin për cilësinë zbatohen për të vlerësuar periodikisht aftësitë mësimdhënëse innovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p> <p><i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_6 Manuali i Cilësisë</i> <i>Ev. 1_17_Udhëzues për kualifikimin e stafit</i> <i>Ev. 1_18_Metodat e mësimdhënies në distancë</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Vlerësimi i studentëve është një nga komponentët e rëndësishëm të vlerësimit të mbarëvajtjes së lëndëve dhe stafit akademik. Studentët janë të përfshirë në vlerësimin periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies e vlerësimit të dijeve, sipas manualeve përkatëse dhe rregullores së vlerësimit të brendshëm të cilësisë. Përveç plotësimit të formularëve përkatës si format e vlerësimit të cilësisë, studentët kanë të drejtë të shprehen në të gjitha format për të vënë në dukje problemet lidhur me cilësinë, si në komunikimet me pedagogët, apo me zyrën e studentëve që kujdeset dhe mbështet studentët në KUQ. Dy herë në vit realizohen pyetësorë, ku në to u kërkohet studentëve të shprehin mendimin dhe vlerësimin e tyre për pedagogët në mënyrën se si ata zhvillojnë lëndët që mbulojnë dhe se sa praktike apo i sukseshëm ka qënë metodologjia dhe praktika e realizuar nga ta.</p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti KUQ</i> <i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_6 Manuali i Cilësisë</i> <i>Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Të gjitha strukturat e institucionit sigurojnë një shërbim cilësor dhe nxisin rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet. I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka një rol kyç në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi NJSBC. Njësia e sigurimit të cilësisë është ndër propozueset kryesore për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë. Senati si organi më i lartë akademik ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Këto struktura janë përgjegjëse jo vetëm për sigurimin dhe monitorimin e cilësisë, por edhe për garantimin e</p>




	<p>transparencës, duke i kaluar analizat e vlerësimit të performancës, të dhënat e pyetësorëve të realizuar etj, nëpërmjet hierarkisë deri në nivel departamenti. Sa i përket publikimit për studentët nuk vihen re publikime të përgjithshme analizash apo rezultatesh në faqen e Internetit që publiku të kuptojë më tepër mbi proceset dhe rezultatet më të thelluara të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti KUQ</i> <i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_36_Faqja zyrtare e internetit</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Si në udhëzuesin e sigurimit të cilësisë, ashtu edhe në dokumente të rregulloreve përkatëse, ka orientime për metodologjinë e vlerësimit të cilësisë dhe performancës në këtë drejtim. Promovimi i shembujve të praktikave më të mira bëhet nëpërmjet vetë studentëve në web-site me dëshmitë e tyre mbi institucionin por edhe tek programet e studimit. Analizat vjetore përmban paraqitje të praktikave më të mira në mësimdhënie. Gjatë vizitës në institucion u evidentuan disa raste të tilla për programin e studimit.</p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti KUQ</i> <i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_36_Faqja zyrtare e internetit</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Ngritja dhe funksionimi i strukturave përkatëse për sigurimin e cilësisë, janë në rrugën e duhur duke funksionuar për matjen dhe vlerësimin e cilësusë. Ka përpjekje sa i përket promovimit të praktikave më të mira të cilat vihen re lidhur me metodat e mësimdhënies apo rritjes dhe zhvillimit të stafit. Këto fakte janë transparente edhe për publikun.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>KUQ së pari, ka ndërtuar në strukturën organizative, organikën përgjegjëse për sigurimin e cilësisë ashtu sikundër parashikon ligji i arsimit të lartë 80/15. Në këtë strukturë, përcaktohen përgjegjësitë për cilësinë sipas Statutit të KUQ dhe rregullores së institucionit. Në planin strategjik KUQ ka disa orientime të forta për cilësinë dhe kjo mbështet një filozofi për rritjen e vazhdueshme të cilësisë dhe përmirësimin në nivle institucional, që do të ndikojë edhe në nivel fakulteti dhe departamenti. Procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë ndërtuar dhe shprehur nëpërmjet rregulloreve përkatëse të strukturave përgjegjëse për cilësinë.</p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti KUQ</i> <i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë</i> <i>Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NjSBC</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Theksojmë se procesi i vlerësimit i realizuar në kuadër të monitorimit të cilësisë rezulton si pjesë e strategjisë së institucionit për cilësinë gjë që bazohet gjithashtu në bashkëveprimin e një sërë hallkash brenda institucionit që janë përgjegjëse për cilësinë në tërësi, duke u nisur që nga burimet nejrëzore dhe matja e performancës, mbështetja e studentëve, etj. Sa i përket bashkëpunimit me ekspertë të jashtëm, momentalisht mungon përfshirja formale e tyre qoftë në rregulloret përkatëse apo dhe në dokumnetacion shoqërues të angazhimeve të ndonje prej aktorëve të jashtëm, sic janë përfaqësuesit me të cilët institucioni ka marrëveshje apo përfaqësuesit e Alumni.</p> <p><i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë</i> <i>EV.3_27 LISTA E MARVESHJEVE NE FUNKSION TE PROGRAMIT</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve</p>	<p>KUQ në dokumentet rregullatore përfshin edhe paketën e instrumenteve për matjen dhe vlerësimin e cilësisë. Në aspektin e sigurimit të Jashtëm të cilësisë ai i është nënshtruar vlerësimeve të jashtme, sic është edhe konkretisht ky proces. Ky program studimi është hera e parë që vlerësohet dhe tregon për rëndësinë që institucioni po i jep procesit të vlerësimit.</p>

analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	<i>Ev. 1_1 Statuti KUQ</i> <i>Ev. 1_5 Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_6 Manuali i Cilësisë</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Treguesit e qartë e të matshëm për të evidentuar cilësinë në mësimdhënie dhe kërkim, pasqyrohen në rregulloret, udhëzuesit dhe dokumenta të tjera institucionale. Konkretisht pedagogët bëjnë një raportim periodik për angazhimin në mësimdhënie, projekte, punë kërkimore dhe punë administrative. Vec vetëdeklarimeve, kontrolli i realizimeve brenda institucionit shërben për matjen e performancës së stafit dhe përfundimet apo dhe problematikat e shfaqura diskutohen në mbledhjet e departamentit, kjo sipas deklarimeve gjatë vizitës në institucion me përgjegjës të departamentit dhe dekanin. Të dhënat përpunohen dhe analizohen përmes analizave vjetore. <i>Ev. 1_1 Statuti KUQ</i> <i>Ev. 1_5 Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_6 Manuali i Cilësisë</i> <i>Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NjsBC</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni bën përpjekje maksimale në procesin e vlerësimit të cilësisë dhe përmirësimit përmes strukturave të duhura. Këtu vetëm një sygjërim do ishte përfshirja e ekspertizës së jashtme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënësve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin	Vlerësimi i programit është proces që kryhet periodikisht, dhe është institucionalizuar përmes metodologjisë së përdorur. Informacionin që mblidhet nga burime të ndryshme, duke nisur me studentët, pedagogët apo mbledhjet formale, institucioni e përdor për të rishikuar ato hallka që janë më të

<p>dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p> <p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>dobëta, apo që duhen përmirësuar si rrjedhim i zhvillimit normal institucional. Këtu patjetër përfshihen kurrikulat që përditësohen edhe si rrjedhim i këtij procesi. Duke rishikuar programet e lëndëve, metodat dhe elemente të ndryshme të procesit të mësimdhënies, procesi i sigurimit të cilesise rezulton në nje metode nga poshte-lart. Sigurimi i brendshëm i cilësisë bëhet në këto mënyra kryesisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nëpërmjet pyetësorëve të drejtuar studentëve (sqaruar në kriterin më sipër) të cilat plotësohen cdo semestër; - nëpërmjet vendosjes së pedagogëve të rinj nën mbikëqyrjen e pedagogëve me eksperience aty ku është e mundur dhe nëpërmjet vlerësimit të performancës së cdo pedagogu mbi baza viti akademik; <p>Ndërkohë analiza e pyetësorëve të studentëve është shumë e qartë dhe e detajuar, por nuk kemi të dhëna të ndara vetëm për këtë program studimi. Njohja e problematikave nga formularët e studentëve trajtohen në mbledhjet e departamentit. Duke u bazuar në dokumentat dhe evidencat që na janë paraqitur mendojmë se analizat në nivel institucional bëhet bazuar mbi formularët e vlerësimit, ndërsa në nivel departamenti dhe programi studimi analiza për të evidentuar se si është përmirësuar cilësia si rrjedhim i përdorimit të të dhënave, është deri diku e kufizuar dhe duhet të zgjerohet. Nga vizita në institucion u evidentuan disa forma të kësaj analize.</p> <p><i>Ev. 1_1 Statuti KUQ</i> <i>Ev. 1_5 Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_6 Manuali i Cilësisë</i> <i>Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NJSBC</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në</p>	<p>Në kuadër të vlerësimit të programit të studimit ka disa prej metodave të drejtpërdrejta që përdoren për të evidentuar mbarëvajtjen dhe problemet. Kështu mund të përmendim vlerësimin e kurrikulës pasi mund të evidentohet që kanë ndodhur ndryshime bazuar përmirësimet e vazhdueshme të syllabuseve të lëndëve apo metodave të përdorura, të evidentuara në analizat vjetore. Sa u përket vlerësimeve të provimeve apo detyrave si dhe vëzhgime në auditor, edhe këto realizohen si pjesë e metodave të drejtpërdrejta dhe kjo doli nga takimi me pedagogët e programit të studimit gjatë vizitës në institucion. Gjithashtu analizat bëhen edhe bazuar</p>




<p>auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>mbi rezultatet e provimeve të ndryshme si ai i diplomimit ku evidentohen notat mesatare.</p> <p><i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i></p> <p><i>Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë</i></p> <p><i>Vizita në institucion, takimi me pedagogët e programit dhe studentët e programit</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Përvec metodave të drejtpërdrejta, edhe metodat e tërthorta shërbejnë për vlerësimin e realizimit të mbarëvajtjes së cilësisë së këtij programi studimi. Sic u shpjegua edhe në kriteret më lart, sondazhet e studentëve bëhen 2 herë në vit duke dhenë rezultatet. Gjithashtu bëhen edhe sondazhe të Alumni për të evidentuar rezultatet në tregun e punës, ndërsa sondazhet tek punëdhënësit apo institucionet bashkëpunuese bëhen në mënyrë informale kryesisht përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe ripërtëritjes së tyre edhe për shkak të nxitjes së marrjes së studentëve cilësorë nga programi i studimit.</p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti KUQ</i></p> <p><i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i></p> <p><i>Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë</i></p> <p><i>Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NJSBC</i></p> <p><i>EV.3_27 LISTA E MARVESHJEVE NE FUNKSION TE PROGRAMIT</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Konkretisht metodat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë janë të ndeshura në gjithë sistemin e cilësisë në KUQ. Këtu përfshihen vlerësimet e kurrikulës, permiresimet e syllabuseve, vlerësimet e detyrave dhe metodave të tjera të mësimnxënies, sondazhet e studenteve, etj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Udhëzuesi i sigurimit të cilësisë parashikon të gjitha politikat dhe procedurat e brendshme për sigurimin e cilësisë dhe paraqet gjithashtu aktorët e brendshëm dhe të jashtëm të interesuar. Ai paraqet rolin e institucioneve drejtuese, si senati akademik, NJSBC, departamenti dhe fakulteti, si orientuese dhe analizuese të të dhënave të cilësisë apo dhe vendimmarrëse në drejtim të përmirësimit të saj bazuar mbi të dhënat e mbledhura. Gjithashtu paraqet rolin e pedagogëve dhe studentëve si burim të dhënash për evidentimin e arritjeve dhe problemeve gjatë procesit të mësimdhënies. Roli i studentëve u tregua edhe më lart me pëmbushjen e detyrimit për plotësimin e pyetësorëve për studentin, si edhe një përfaqësues i studentëve është përfshirë në procesin e vlerësimit të brendshëm. Roli i pedagogëve është për vlerësimin e punës vetjake apo dhe të kolëgëve, në rang departamenti. Nuk ka formularë apo evidenca dokumentare për vlerësimin nga aktorë të jashtëm, prandaj shtimi i tyre në të ardhmen do t'i jepte më shumë vlerë procesit, por mungesa momentale e tyre nuk e dëmton atë, pasi ka vlerësime nga aktorë të jashtëm si bizneset me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>Ev. 1_5 Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_6 Manuali i Cilësisë</i> <i>Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NJSBC</i> <i>EV.3_27 LISTA E MARVESHJEVE NE FUNKSION TE PROGRAMIT</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Statuti i KUQ përcakton të gjitha strukturat, me përgjegjësitë dhe detyrat e tyre si për njësitë edhe për studentët, pedagogët dhe palët e interesuara për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. Kështu thekson rolin e NJSBC në nivel institucional duke përcaktuar detyrat gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë. Gjithashtu në politikat e tij KUQ garanton edhe mundësitë për trajnim dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së stafit duke mundësuar këto zhvillime. Gjatë vizitës në institucion u vërejt se detyrat e këtyre njësie aktualisht po realizohen sic duhet</p>



	<p>për të përmbushur procesin dhe zbatuar me rigorozitet rregulloret dhe statutin.</p> <p><i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë</i> <i>Ev. 1_5_2 Raporti Vjetor i NjsBC</i> EV.3 MOBILITETE ME UNIVERSITETET NE KUADER TE PROGRAMEVE ERASMUS + <i>Ev. 1_7_Politikat e vlerësimit të brendshëm</i> <i>Ev. 1_17_Udhëzues për kualifikimin e stafit</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore janë themelore për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Nga sa u përmend edhe në standartin VI 3 si dhe në kriteret e mësipërme të këtij standarti, pedagogët e njësisë bazë së pari bëjnë vetëvlerësimin nëpërmjet formularëve, por edhe japin vlerësimet e tyre në mbledhjet me synim analizën e mësimdhënies dhe të kërkimit. Procesi përfshin gjithashtu fakultetin sepse informacioni përcillet në nivel fakulteti për tu përpunuar më tej në analizat vjetore. Personeli ndihmës akademik dhe administrativ gjithashtu përfshihet me dhënie e mendimeve sipas problematikave nëse ka dhe sipas kompetencave. Studentët përfshihen përmes sondazheve me frekuencën e përcaktuar.</p> <p><i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë</i> <i>Ev. 1_7_Politikat e vlerësimit të brendshëm</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Përfshirja e të gjithë aktorëve të brendshëm garanton dhe respekton integritetin akademik dhe shmang diskriminimet apo pabarazitë. Kjo garantohet nëpërmjet Udhëzuesit të cilësisë si dhe formateve të miratuara të pyetësorëve për vlerësimin e procesit mësimor. Miratimi i tyre si edhe marrja përsipër e ruajtës së konfidencialitetit dhe të dhënave personale garantohet si si nga departamenti, ashtu edhe nga institucioni në përgjithësi përmes rregulloreve përkatëse.</p> <p><i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë</i> <i>EV.3_4_Rregullore departamenti</i></p>

<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p><i>Sa i përket ekspertëve të jashtëm, gjatë procesit të vlerësimit nuk ka të tillë, por janë konsideruar mendime nga profesionistë dhe kompanitë dhe organizatat me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi, si burime të informacionit për vlerësimin e programit ose moduleve apo pjesëve të tij, kjo sidomos për modulën e praktikës mësimore.</i></p> <p><i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_6_Manuali i Cilësisë</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Duhet të përmirësohet procesi dhe sistemi i vlerësimit në kuadër të përfshirjes formale e aktorëve të jashtëm, të cilët përmenden në kriterin 1 dhe 5 të këtij standarti.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Standardi VI.5</p> <p>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>KUQ vendos informacion për publikun në web-sitin zyrtar. Të gjitha veprimtaritë në kuadër të sigurimit të cilësisë, raportet politikat dhe strategjitë sipas deklaratave zyrtare transmetohen nëpërmjet komunikimit të brendshëm dhe janë transparente për të gjithë të interesuarit. Publiku, studentët dhe gjithë të interesuarit aktualisht gjejnë informacion mbi cilësinë e studimeve në Universitetin KUQ, por disa prej dokumenteve janë për përdorim të brendshëm, duke ruajtur edhe konfidencialitetin dhe në zbatim të rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti KUQ</i> <i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_10_Rregullore e mbrojtjes së të dhënave personale</i> <i>Ev. 1_11_Rregullore për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit</i></p>

	https://qiriazhi.edu.al/njsbc/
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>Sistemi i sigurimit të brendshëm të Cilësisë ndërtohet mbi parimin e transparencës. Transparenca brenda institucionit garantohet nëpërmjet komunikimit të brendshëm dhe hierarkisë institucionale, detyrimeve të njëjësive përgjegjëse për cilësinë për të ndarë informacionin me stafin dhe studentët. Nga ana tjetër raportet që mendohet se janë relevante mund të vendosen edhe në web-site në periudhat përkatëse të vlerësimit. Aktualisht në Web-site gjenden raportet e mëparshme të vlerësimit.</p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti KUQ</i> <i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 1_10_Rregullore e mbrojtjes së të dhënave personale</i> https://qiriazhi.edu.al/akreditimi-periodik-institucional/ https://qiriazhi.edu.al/akreditimi-i-programeve-te-studimit-2/</p>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>Planet e masave për përmirësimin e mangësive janë ndërtuar dhe realizuar në kuadër të analizave institucionale, mbledhjeve të departamentit apo në nivel fakulteti. Dokumentet e rregulloreve përkatëse përcaktojnë dhe procedurat se si do të ndërtohen dhe zbatohen planet e masave, apo kush i ka përgjegjësitë për to. Nga vizita në institucion u pa se ka një strukturë të përcaktuar për të arritur synimet e përmirësimin të procesit të cilësisë dhe zgjidhjes së problematikave të lidhura me këtë proces.</p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti KUQ</i> <i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i> <i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev. 3_4_Rregullore departamenti</i> <i>Ev. 3_5_Analiza vjetore e departamentit</i></p>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>KUQ vlerëson dhe favorizon përshkallëzimin e metodikës në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në këtë drejtim përfshirja dhe aktivizimi i të gjithë aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit është një nga objektivat kryesore të institucionit.</p> <p>Kolegji është gjithashtu shumë transparent lidhur me çfarëdo informacioni, mase apo aktiviteti që duhet të ndërmeret lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Transparenca duket qartë në mbledhjet e departamentit të Menaxhimit.</p>

	<p>KUQ mendon se fryma e transparencës që ka arritur të aplikojë, është baza e shmangies të çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti KUQ</i> <i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i> <i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev.3_4_Rregullore departamenti</i> <i>Ev.3_5_Analiza vjetore e departamentit</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Megjithëse mungojnë format e institucionalizuara, KUQ dhe departamenti konsultohen në mënyrë të vazhdueshme me aktorë të jashtëm dhe palë të treta, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Institucioni përmes pyetësorëve dhe përmes mbledhjeve të hapura ndërgjegjëson studentët dhe personelin për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit të cilësisë në universitet.</p> <p><i>Ev. 1_1_Statuti KUQ</i> <i>Ev. 1_4_Rregullore e Kolegjit</i> <i>Ev. 1_5_Rregullore e NJSBC</i> <i>Ev.3_4_Rregullore departamenti</i> <i>Vizita në institucion, takimi me dekanin dhe NJSBC</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Transparenca dhe gjithëpërfshirja e aktorëve në zbatim garantohet nga strukturat e mirëpërcaktuara në detyrime dhe përgjegjësi apo dhe të drejta, si dhe nga eksperiencia institucionale në këto drejtime.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Menaxhim Hoteleri Turizem” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Kolegji Universitar Qiriazi”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Kolegji Universitar Qiriazi ka nje koherence të gjatë në treg, përben një ndër IAL e hapura herët në tregun e arsimit të lartë dhe ka experience të mëparshme të konsiderueshme në programet e studimit në fushën e ekonomisë në përgjithësi, duke përfshirë shkencat e menaxhimit dhe turizmin.
2. Institucioni ka një emër të mirë në treg
3. Staf i lëndëve kryesore ekonomike është me tituj dhe grada, duke siguruar një proces cilësor të mësimdhënies dhe është i mirënjohur në vend.
4. Pasja e nje program 2 vjecar professional ne turizem ben qe të ketë një experience paraprake në këtë sektor.
5. Njësia bazë që e ofron reflekton cilësi për të gjithë IAL, rrjedhimisht është një bazë e mirë për të mbështetur dhe këtë program studimi

Pika të dobta:

1. Staf i jep mesim në lëndët e turizmit ka nevojë të diversifikohet dhe të rrite cilësinë në një kuptim të përgjithshëm. Pra, përderisa në lëndët e tjera ekonomike apo ato bazë japin mesim në këtë program studimi pedagogë me tituj profesor dhe profesore të asociuar, me emër në fushën e ekonomisë, është e nevojshme që kjo të shoqërohet me rritje sasiore dhe cilësore të stafit si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm që jep mesim në lëndët e turizmit. Bëhet fjalë për një program mesimor në turizëm, prandaj është bazike cilësia e mesimdhënies dhe stafet që japin mesim në këto lëndë. [(Standarti I.1 Kriteri 4)].
2. Numri i ulët i studentëve, [(standarti V.1 kriteri 5)].
3. Mungesë e literaturave shqip të kohëve të fundit, apo referencë jo e qartë e tyre në syllabuset e programit, në disa lëndë të lidhura me fushën specifike të studimit. Këto jane të dukshme në [(standartin II.4, kriteri 3, 4)].

Rekomandime:

1. Të përfshihen më shumë lëndë turizmi në tërësinë e programit, me më shumë kredite dhe orë mësimore
2. Te rishikohen syllabuset për të qenë në përputhje me VKM 41, temat të mos kenë përplasje, rifreskim i literaturave dhe përfshirje e literaturave shqip të kohëve të fundit (jane dhene shenimet perkatese per syllabuset)
3. Lenda Manaxhim Turizmi te zevendesohet me Lenden Manaxhim Turizmi Qendrueshem, Lenda Drejtim Marketingu te zevendesohet me Marketingu Turizmit, te



shtohet nje shportë me lendë me zgjedhje vetëm për turizmin. Këto reflektime të bëhen në mënyrë graduale, vit pas viti, duke zbatuar ndryshimet prej jo më shumë se 20%.

4. Të rritet cilësia dhe sasia e stafit që është eksperte në fushën e turizmit, stafi me kohe të pjesshme të jetë me grada dhe ekspertizë në këtë fushë. I pedagog mund te mbaje shume lende por duhet t'i kete te shperndara edhe ne programe te tjera apo lende te tjera (jo te turizmit), sepse cenohet dija dhe aftesite qe marrin studentet nese edhe ato pak lende turizmi jepen nga 1 apo 2 lektore.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Management of Hospitality and tourism" provided by the Higher Education Institution "University College Qiriazi"

Strengths and affirmations

1. Qiriazi University College has a long time in the market, as one of the HEIs with a coherence in its programs in the higher education market and with a significant previous experience in study programs in the field of economics in general, including management sciences and tourism.
2. The institution has a good name in the market.
3. The staff of the main courses in economics have titles and grades, ensuring a quality teaching process, with a well-known experience in the country.
4. Having a 2-year professional program in tourism means having a prior experience in this sector.
5. The basic unit that offers the program reflects quality for all HEIs, therefore it is a good basis to support this study program as well.

Weaknesses

1. The staff teaching tourism courses needs to diversify and increase the quality in a general point of view. While, well-known professor and associate professors, experts in national level and with a good experience in the field of economics, are teaching the basic courses in this study program, the staff that teaches the tourism courses are not in the same level. It is necessary a quantitative and qualitative improvement of the full time and part time staff, who teach tourism courses, filling a basic need for a tourism based study program. [Standard I.1, criteria 4].
2. Low number of students as per [standard V.1, criteria V].
3. Lack of recent Albanian literature. Even in courses where there is an Albanian literature reference, it is not clear and/or not correct represented in the syllabuses of the program, in some subjects related to the specific field of study. [Standard II.4, criteria 3,4].



Recommendation

1. Include more tourism subjects in the whole program, with more credits and teaching hours
2. Revise the syllabi to be in line with VKM 41, the topics should not clash, refresh the literature, and include recent Albanian literature (the relevant notes for the syllabi are given)
3. The course of Tourism Management should be replaced with the subject of Sustainable Tourism Management, the subject of Marketing Management should be replaced with Tourism Marketing, and a basket of selected courses only for tourism should be added. These reflections should be done gradually, year after year, implementing changes of no more than 20%.
4. Raise the quality and quantity of the staff who are experts in the field of tourism, the part-time staff should have degrees and expertise in this field. 1 lecturer can teach many subjects, but they must be distributed in other programs or other subjects (not tourism), because the knowledge and skills that the students get are affected if those few tourism subjects are taught by 1 or 2 lecturers.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X